Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

ProPeace

Broshurë

Akademia në fushën e raportimit për ballafaqimin me të kaluarën (BmK) dhe raportimin e sensibilizuar për konflikt

Trajnimi për trajner

Përmbajtja

Mirësevini! 2

Rreth Akademisë 3

Kronologjia e Akademisë së Trajnimit 4

Trajnerët dhe Pikat Kryesore 5

Prof. Dr. Dinko Gruhonjic 6

Adriatik Kelmendi 7

Serbeze Haxhiaj 8

Ridvan Slivova 9

Artikujt e pjesëmarrësve 10

Artikulli 1 — Adelina Ahmeti — Lufta që vazhdon brenda tyre: Trauma e gazetarëve që raportuan nga zonat e luftës në Kosovë 11

Artikulli 2 — Ardita Zeqiri — “Divani plot me vrima plumbash”: Familjet kosovare që jetojnë në vendet e krimeve të luftës 16

Artikulli 3 — Besian Beha — Atdhe Hetemi: Do ta finalizojmë brenda vitit bazën zyrtare të të dhënave për viktimat e luftës dhe personat e zhdukur 23

Artikulli 4 — Besnik Gashi — “Kam edhe unë diçka në bark”, shtatë vite jetë, njëzet e tetë vite kujtim 36

Artikulli 5 — Blerta Dalloshi Berisha — Minat vazhdojnë të marrin jetë në Kosovë 41

Artikulli 6 — Fatmir Menekshe — Po kërkoj shtëpinë time të humbur në Moravskë 43

Artikulli 7 — Fisnik Minci — Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha 46

Artikulli 8 — Jehona Hulaj — Nga Reçaku te bombardimet e NATO-s, rrëfimi i Vjosa Sadriu-Hamiti për gazetarinë e luftës 54

Artikulli 9 — Lendrit Qeli — “Me plis kam le, me plis dua të vdes” 57

Ekipi i projektit 61

Mirësevini!

Mesazh nga organizatorët

Jemi të lumtur t'ju mirëpresim në këtë broshurë, e cili përmban reflektime dhe artikuj nga gazetarët që morën pjesë në Trajnimin e Trajnerëve në Akademinë në Fushën e Raportimit për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Raportimin e Sensibilizuar për Konflikt. Kjo nismë, e organizuar bashkërisht nga Pro Peace – Programi i Kosovës dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt gazetarisë së përgjegjshme dhe etike në vendin tonë.

Rreth broshurës

Një projekt bashkëpunuese që bashkon gazetarë, trajnerë dhe ekspertë të ndërtimit të paqes.

Misioni i përbashkët

Nxitja e dialogut, kujtesës dhe pajtimit përmes rrëfimit të sensibilizuar ndaj konflikteve.

Rreth Akademisë

Program treditor i Trajnimit të Trajnerëve

Akademia e Trajnimit të Trajnerëve mblodhi gazetarë me përvojë në një program intensiv treditor, të fokusuar në ballafaqimin me të kaluarën dhe raportimin e sensibilizuar ndaj konflikteve. Përmes moduleve interaktive, shkëmbimit të përvojave ndërmjet kolegëve dhe punës praktike në krijimin e përmbajtjeve mediale, pjesëmarrësit zhvilluan aftësitë profesionale dhe bazën etike të nevojshme për të trajnuar të tjerët në fushën e gazetarisë së përgjegjshme.

Objektivat

Pajisja e trajnerëve me njohuri, metoda dhe mjete praktike për gazetari të ndjeshme ndaj konflikteve, të informuar për traumën dhe të mbështetur në parime të larta etike profesionale.

Profili i grupit

Gazetarë dhe redaktorë të përkushtuar ndaj raportimit të përgjegjshëm, promovimit të dialogut dhe ndërtimit të narrativave që kontribuojnë në paqe dhe mirëkuptim shoqëror.

Fokusi i temave

Përballja me të kaluarën, kujtesa kolektive, pajtimi, ndjeshmëria gjinore dhe zhvillimi i përmbajtjeve mediatike pasuese mbi këto tema.

Agjenda e Akademisë së Trajnimit

Pasqyrë e Programit të Akademisë

Një program intensiv treditor i Trajnimit të Trajnerëve mbi Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Raportimin e Sensibilizuar ndaj Konfliktit, i cili ndërthurte kornizat teorike me prodhimin praktik të përmbajtjeve mediatike.

Dita 1
Hyrje dhe Kujtesa në Gazetari

Sesioni mbi bazat themelore të rolit të gazetarisë në kujtesën historike, përballjen me të kaluarën dhe hartimin me përgjegjësi të narrativave të konfliktit.

Dita 2
Etika dhe Ndjeshmëria në Raportim

Sesione mbi etikën në gazetari, ndjeshmërinë gjinore, raportimin e informuar për traumën, si dhe mbrojtjen e dinjitetit të të mbijetuarve dhe burimeve të informacionit.

Dita 3
Prodhimi i Përmbajtjeve Mediatike

Përmes ushtrimeve praktike në prodhimin fotografik, pjesëmarrësit praktikuan parimet e raportimit të ndjeshëm ndaj konflikteve, duke parë mënyrën se si rrëfimi vizual mund të kontribuojë në ndërtimin e narrativave etike, të balancuara dhe të përgjegjshme për të kaluarën.

Trajnerët dhe pikat kyqe

Prof. Dr. Dinko Gruhonjić

Profili i trajnerit

Prof. Dr. Dinko Gruhonjić është një gazetar, akademik dhe ekspert i medias, me përvojë të gjerë në raportimin e ndjeshëm ndaj konflikteve dhe drejtësinë tranzicionale. Ai njihet si një nga zërat më të rëndësishëm në diskutimet mbi rolin e gazetarisë në shoqëritë pas konfliktit, duke promovuar narrativa etike dhe të bazuara në fakte që kontribuojnë në pajtim dhe përgjegjësi historike.

Pikat kyqe

Gjatë sesioneve së tij, Prof. Dr. Gruhonjić theksoi se gazetaria që trajton të kaluarën kërkon jo vetëm saktësi faktike, por edhe një përgjegjësi të thellë etike. Ai i theksoi rreziqet e keqpërdorimit të narrativave historike për qëllime politike ose ideologjike dhe i inkurajoi gazetarët që t'u qasen çështjeve historike me integritet profesional, mendim kritik dhe përkushtim ndaj interesit publik.

Adriatik Kelmendi

Pikat kyqe

Adriatik Kelmendi diskutoi sfidat e gazetarisë në kontekste të polarizuara, duke theksuar se raportimi i balancuar dhe profesional është thelbësor për nxitjen e dialogut publik dhe shmangien e thellimit të ndarjeve shoqërore. Ai vuri në pah rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë editoriale dhe rezistencës ndaj presioneve që mund të cenojnë standardet gazetareske, veçanërisht kur raportohet për çështje të ndjeshme shoqërore.

Profili i trajnerit

Adriatik Kelmendi është gazetar, shkrimtar, prezantues televiziv, drejtues mediatik, ligjërues dhe aktivist shoqëror. Ai gjithashtu ishte ndër gazetarët e parë që raportuan për masakrat në Kosovë gjatë luftës, duke kontribuar në dokumentimin e hershëm dhe ndërgjegjësimin ndërkombëtar për krimet e luftës.

Serbeze Haxhiaj

Profili i trajneres

Serbeze Haxhiaj është gazetare investigative e vlerësuar me çmime dhe avokuese e të drejtave gjinore, me përvojë të gjerë në raportimin e konflikteve në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ajo ka raportuar mbi shoqëritë pasluftës, drejtësinë tranzicionale dhe dëshmitë e të mbijetuarve, duke sjellë në praktikën e saj gazetareske dhe trajnuese një qasje të informuar për traumën dhe të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore.

Pikat kyqe

Serbeze Haxhiaj theksoi rëndësinë e një qasjeje të ndjeshme gjinore dhe të informuar për traumën, duke vënë në dukje se mënyra se si raportohen përvojat e të mbijetuarve ndikon drejtpërdrejt në dinjitetin, sigurinë dhe procesin e tyre të shërimit. Ajo inkurajoi gazetarët që t'i japin përparësi empatisë, marrjes së pëlqimit të informuar dhe praktikave etike të rrëfimit gjatë punës me individë dhe komunitete të cenueshme.

Ridvan Slivova

Pikat kyqe

Ridvan Slivova theksoi fuqinë e fotografisë në formësimin e kujtesës kolektive, duke nënvizuar se fotografia nuk është vetëm dokumentim, por edhe interpretim, dhe për këtë arsye kërkon ndjeshmëri të lartë etike kur trajtohen temat e lidhura me konfliktin. Përmes sesionit praktik, ai udhëhoqi pjesëmarrësit në zbatimin e parimeve të raportimit të ndjeshëm ndaj konflikteve në rrëfimin vizual, duke eksploruar mënyrën se si imazhet mund të informojnë publikun duke ruajtur dinjitetin dhe duke shmangur përfaqësimet e dëmshme.

Profili i trajnerit

Ridvan Slivova është fotograf profesionist me përvojë të gjerë në dokumentimin e konfliktit, kujtesës dhe transformimeve shoqërore në Ballkanin Perëndimor. Puna e tij fokusohet në përgjegjësitë etike të foto-gazetarisë në shoqëritë pas konfliktit, dhe ai ka kontribuar në shumë ekspozita lokale dhe ndërkombëtare mbi rrëfimin vizual dhe dokumentimin e ndjeshëm ndaj konflikteve.

Produktet Mediale të Pjesëmarrësve

*Këto prodhime mediatike janë produkte të Akademisë për Raportimin mbi Përballjen me të Kaluarën dhe Gazetarinë e Ndjeshme ndaj Konflikteve, e zbatuar nga Pro Peace – Programi në Kosovë dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). Pikëpamjet e shprehura në këto prodhime janë përgjegjësi e plotë e gazetarëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Pro Peace apo AGK.

**Emrat dhe artikujt në këtë publikim janë paraqitur sipas rendit alfabetik për qartësi editoriale dhe nuk përfaqësojnë ndonjë renditje apo hierarki mes kontribuuesve.

***Artikujt origjinalë janë të shkruar në gjuhën shqipe.

Lufta që vazhdon brenda tyre: Trauma e gazetarëve që raportuan nga zonat e luftës në Kosovë

Adelina Ahmeti

"I thash vetes: "E kam shtyrë jashtëzakonisht shumë ballafaqimin me të vërtetën edhe atë se çka kam pa para 26 vjetëve". Vendosa me shku te kompleksi i Jasharëve. Mbërrita aty. Nuk e gjeja forcën me dalë prej veturës, nuk gjeja forcë, edhe shpërtheva me qajtë me të madhe sepse i pash skenat".

Kështu e kujton tentimin për t'u ballafaquar me traumën e raportimeve gjatë kohës së luftës Ilire Zajmi derisa lotët vazhdojnë ende t'i rrëshqasin nëpër faqe dhe ndalet për pak sekonda për ta rimarrë veten e për të vazhduar rrëfimin e saj.

Gjatë luftës në Kosovë, gazetarët ishin ndër dëshmitarët e parë të dhunës, shpërnguljeve dhe pasojave njerëzore të konfliktit. Përderisa dokumentonin ngjarjet në terren dhe informonin opinionin publik, shumë prej tyre u ekspozuan vazhdimisht ndaj situatave traumatike që lanë pasoja edhe pas përfundimit të luftës.

Megjithatë, ndikimi i kësaj përvoje në shëndetin mendor të gazetarëve ka mbetur një temë pak e trajtuar, shpesh e heshtur nga paragjykimet sociale dhe mungesa e diskutimit publik për traumat psikologjike.

Ilire Zajmi në vitin 1999 ishte 28-vjeçare dhe punonte si gazetare për media në Kosovë dhe media ndërkombëtare.

Një gazetare e re në moshë, e papërgatitur për atë se çka po e priste në terren, Ilire Zajmi, bashkë me kolegë të tjerë gazetarë, nisi udhëtimet drejt zonave të ndryshme të Kosovës për të dokumentuar dhe raportuar për masakrat, vrasjet, dëbimet dhe djegien e fshatrave nga forcat serbe të sigurisë.

Për herë të parë ajo kishte dalë në terren gjatë luftimeve në Drenicë, në vitin 1998.

Lufta që vazhdon brenda tyre: Trauma e gazetarëve që raportuan nga zonat e luftës në Kosovë

“Në disa fshatra të Drenicës, kishim dëgjuar që ka luftime. E kujtoj për herë të parë që kam fillu me u dridhë. M’u duk se si diçka, i thash vetes: “O Zot, a jam mirë unë, pse erdha? Aty e kam pasë përvojën time të parë traumatike kur i kam dëgju rafalet e armëve dhe luftimet” – thotë Zajmi.



Ilire Zajmi, në mesin e gazetarëve, Foto/ KALLXO.com

Përvojat që Ilirja i përjetoi gjatë raportimit të luftës në Kosovë në vitet 1998-1999 thotë se edhe sot i kujtohen dhe pasojat vazhdon t’i vuajë ende.

“Ndër pasojat më të mëdha që edhe sot e kam është kur shkuam në Prekaz, ende sot e vuaj. Shkuam në Prekaz dhe pamë që gjithë aparati serb po i nxirrte viktimat e familjes Jashari nga një gropë e madhe ku i kishin futur” – shpjegon Zajmi momentin kur po shihte trupat e familjes Jashari nga një perimetër prej rreth 100 metrash.

Siç edhe tregon, Ilires i janë dashur ditë të tëra për ta përceptuar dhe për ta kaluar atë që kishte parë.

“Sa herë provojsha me flejtë, ato skena domethënë vazhdimisht më janë përsëritë në kokë” – kujton Ilire Zajmi, derisa tregon se në atë kohë në vendin e ngjarjes ishte bashkë me një kolege nga revista “Kosovarja” dhe një gazetar italian nga “La Repubblica”.

Përveç asaj që kishte parë te familja Jashari, Ilire Zajmi kujton edhe masakrën në Rogovë të Hasit.

“Policia u kishte hyrë në 6 të mëngjesit, kishte marrë njerëzit nga dhomat e gjumit, i kishte vrarë, masakruar dhe i kishin veshur me uniformat e UÇK-së, u kishin vendosur armë, pra e kishin inskenuar gjithë skenën” – thotë Zajmi.

Ilire Zajmi thekson se ato që pa para 27 vitesh i ka ende kujtime të freskëta dhe se kohë pas kohe i rikthehen në mendje.

Të gjitha këto kujtime, trauma dhe ndjenja që kishte nga raportimet gjatë luftës, Zajmi thotë se i ka diskutuar me kolegë të saj, por nuk ka marrë ndonjëherë trajtim profesional psikologjik.

Lufta që vazhdon brenda tyre: Trauma e gazetarëve që raportuan nga zonat e luftës në Kosovë



Musa Kurhasku, në atë kohë gazetar që raportonte për Radio Televizionin Shqiptar, gjatë luftës, përveç raportimeve për masakrat dhe vrasjet që ndodhën në zonën e Dukagjinit, raportoi edhe për familjarë e të afërm të tij.

Kurhasku, në kohën e luftës, në vitin 1999, nuk kishte raportuar vetë për vëllanë e tij të vrarë nga forcat serbe.

"E kam urdhëru një koleg timin, shokun tim, nuk e kam raportuar unë, jo se nuk e përballoja por thjesht më dukej e pabesueshme, nuk i besojsha edhe vetvetes prandaj, sepse e kemi pasë një lidhje shumë të ngushtë" – rrëfen Kurhaskaj.

Ai kujton edhe vitet paraprake para bombardimeve të NATO-s, për të cilat thotë se kishte shumë situata që ende sot nuk i largohen nga mendja.

"Deri në ditën kur ka përfundu lufta dhe pas luftës kemi raportu, sepse ka pasur edhe shumë gjëra që kanë ndodhur dhe i kemi parë edhe pas luftës. Më ka ra me qenë në masakrën e Loxhës, të them të vërtetën për 2 apo 3 muaj më kujtohet që nuk m'u ka largu era e të vdekurve, e kufomave" – rrëfen Kurhaskaj.

Musa Kurhasku, gazetar i RTSH në vitin 1999 – Foto: Musa Kurhasku

Ndonëse kanë kaluar 27 vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë, Kurhasku thotë se përjetimet vazhdojnë ta ndjekin.

"Ato përjetime i ke edhe kur ballafaqohesh me familjet e viktimave të të vrarëve. Sa herë shkoj në përvjetore të masakrave i përjetoj sërish, i kujtoj ato çka kemi pa dhe raportuar në kohë të luftës" – shpjegon ai.

Ridvan Slivova është fotoreporter, i cili dokumentoi përmes fotografive dhunën dhe sistemin represiv të regjimit serb në Kosovë. Ai e kishte nisur punën me fotografim si i ri, fillimisht me pamje artistike.

Në vitin 1990 ai realizoi fotografitë e para profesionale në aspektin gazetaresk, kur deputetët e asaj kohe shpallën Kosovën Republikë.

Ai kujton se kishte parë vazhdimisht situata të dhimbshme, por fotografia e parë me një viktimë mbetet ndër më të rëndat.

Lufta që vazhdon brenda tyre: Trauma e gazetarëve që raportuan nga zonat e luftës në Kosovë

“Kur erdhi ushtria në atë kohë dhe sollën lajmin unë dola menjëherë, ajo ka qenë fotografia e parë me kufomë që kam realizuar. Fotografia ime ishte publikuar në disa gazeta edhe në Slloveni dhe kur ishte botuar pas 80 ditësh ma dërguan gazetën ku ishte botuar dhe atëherë kuptova se ajo çka po bëja ishte dokumentim historik” – shpjegon Slivova.

Pas kësaj, ai kishte raportuar nga fshatrat e Drenicës: Prekaz, Polac, Klinë dhe Qirez.

“Kishim shpesh raste tepër të rrezikshme ku as vet s’e dija nëse të nesërmen do të dilja në terren” – thotë ai.

Në mendjen e tij ende mbetet kolona e Gollakut.

“Ishte kolonë e viktimave të Gollakut në Prishtinë. Unë edhe sot i kam vizituar 90 për qind të vendeve prej ku kam fotografuar. Më kthehen kujtimet menjëherë, por tani është më ndryshe e ndjej vetëm erën e lirisë, kur e shoh aparatin që mbaj lirshëm e kujtoj këtë, sepse në kohë lufte ne duhej ta fshihnim aparatin që të mos zbuloheshim para policisë serbe” – shton ai.

Slivova thotë se menjëherë pas luftës kishte kërkuar🤝ndihmë psikologjike te një mik i tij.

“I kisha mbledhur rreth 200 fotografi nga masakrat, përndjekjet. Gjatë bisedave të gjata u mundova të trajtoj traumat bashkë me të (shokun psikolog)” – thotë ai.

Gresa Miftari është psikologe klinike. Ajo përjetimet e gazetarëve që raportojnë nga zonat e konfliktit dhe luftës i lidh me stresin post-traumatik (PTSD), ankthin, depresionin, traumën sekondare.

Miftari shpjegon edhe arsyet pse pas luftës nuk kishte fokus në trajtimin e shëndetit mendor, përfshirë edhe për gazetarët.

Lufta që vazhdon brenda tyre: Trauma e gazetarëve që raportuan nga zonat e luftës në Kosovë

“Pas luftës, si shoqëri jemi fokusuar më shumë te rindërtimi ekonomik dhe institucional, kurse shëndeti mendor nuk ka qenë temë që diskutohej shumë publikisht. Mandej nuk kemi pasur edhe shërbime që kanë qenë të mirëthemeluara për të bërë trajtim dhe as ndërgjegjësim. Profesionistët e parë të trauma-terapisë i kemi pasur tek në fundin e të 2000-tave, kur kishin kaluar vite të tëra që njerëzit, përfshirë gazetarë/e, po jetonin me dhimbje të heshtur” – shpjegon ajo.



Sipas saj, mbështetja për trajtimin e shëndetit mendor, si në të kaluarën ashtu edhe sot, është ofruar më shumë nga organizatat joqeveritare dhe iniciativat individuale.

“Kjo sigurisht lidhet edhe me resurset më të vogla që kemi pasur si shtet në transformim si dhe me mungesën e njohurive dhe qasjeve të duhura” – thekson Miftari.

Vegëza e plotë në gjuhën shqipe**: https://kallxo.com/lajm/lufta-qe-vazhdon-brenda-tyre-trauma-e-gazetareve-qe-raportuan-nga-zonat-e-luftes-ne-kosove/**

“Divan plot vrima plumbash”: Kur shtëpia është edhe skenë e krimit të luftës

Ardita Zeqiri

Mes kujtimeve traumatike dhe jetës së përditshme, shumë të mbijetuar të masakrave të luftës në Kosovë vazhduan të jetonin brenda shtëpive ku u vranë të afërmit e tyre.

Në dhomën e ndejës së shtëpisë së familjes Gërxhaliu, në fshatin Studime e poshtme në komunën e Vushtrrisë, fotografitë e 13 anëtarëve të familjes që u vranë nga forcat serbe më 31 maj 1999 janë vendosur me kujdes mbi divanin e vjetër.

Shtatë nga viktimat ishin fëmijë.

“Këtu kemi jetu me Lisën”- tha Gërxhaliu, duke iu referuar vajzës së tij Elisa me nofkën e saj- ulur në dhomën ku kishte ndodhur masakra.

Nexhmedin Gërxhaliu u kthye në shtëpi nga Gjermania në mesin e qershorit 1999, disa ditë pasi trupat e NATO-s hynë në Kosovë pas një fushate bombardimi ajror prej 78 ditësh.

Një vend që mbante kujtime të panumërta të fëmijërisë ishte shndërruar në vend masakre.

Gërxhaliu, tash 64 vjeç, dhe vajza e tij Elisa, 20 vjeçe, vazhduan të jetonin në shtëpinë ku 13 anëtarë të familjes së tyre ishin masakruar, deri në vitin 2018.

Që atëherë, shtëpia ka mbetur bosh dhe pritet të shndërrohet në muze. Ajo është një nga disa lokacione në Kosovë të lidhura me masakrat e luftës që institucionet po përpiqen t’i ruajnë si memoriale.

Megjithatë, Ministria e Kulturës tha se procesi nuk është pa sfida. Në disa raste, të mbijetuarit e masakrave ose familjarët e viktimave vazhdojnë të jetojnë në këto vende, shpesh sepse nuk kanë zgjidhje tjetër.

“Divan plot vrima plumbash”: Kur shtëpia është edhe skenë e krimit të luftës

Për shumë të mbijetuar në gjithë Kosovën, vendet e krimeve të luftës nuk janë memoriale të largëta, por hapësira të jetës së përditshme.



Në fundin e atij Maji, Gërxhaliu humbi gruan e tij të parë, djalin, vëllanë, kunatën, nënën, gjashtë mbesa e nipër dhe kushëririn. Një nip tjetër ishte vrarë disa ditë më herët në qytet.

Vëllai i tij Selatini, së bashku me djalin Shabanin dhe kushëririn Xhemajlin, u ekzekutuan jashtë, ndërsa të tjerët u vranë brenda shtëpisë.

“Tragjedia ishte e randë, jo vendimi mu kthy me jetu në këtë shtëpi” shpjegon ai, duke shtuar se “jeta më pas ishte katastrofike — me padrejtësi, pa përgjigje”.

Sfidat e kthimit të shtëpive në memoriale

Pothuajse asgjë nuk ka ndryshuar brenda shtëpisë së Gërxhaliut që nga ajo ditë e majit të 1999.

Vrimat e plumbave ende shihen në mure. Mobiliet kanë mbetur saktësisht aty ku ishin.

“Edhe divanet janë të njëjtat”- tha Gërxhaliu. “I kemi mbulu se janë plot me vrima plumbash.”

Ai tani jeton afër, por kthehet rregullisht për ta mirëmbajtur pronën. Të jetuarit aty, tha ai, nuk ishte kurrë frikësues.

“Sa jetuam këtu, disi u pajtuam”. Tash që vij më rrallë dhe jetoj më larg, është ma e rëndë.”

Edhe për Elisën, shtëpia nuk është ndjerë kurrë si e përhumbur. “Për mu dhe babin, nuk ishte kurrë e frikshme apo traumatizuese të jetonim këtu”- tha ajo.

Megjithatë, duke kujtuar rritjen mes mungesës dhe duke qëndruar përballë fotografive të gjysmëvëllait dhe të afërmve që nuk i kishte njohur kurrë, zëri iu drodh teksa kujtonte si ishte rritur duke parë babanë dhe hallat e saj të qanin për të afërmit që kishin humbur.

“Divan plot vrima plumbash”: Kur shtëpia është edhe skenë e krimit të luftës

“Tash une jam gjaku i vetëm në këtë shtëpi”- tha Elisa, duke shtuar se “kam menduar 100 mijë herë si do të kishte qenë jeta po të ishin gjallë.”

Sipas Ministrisë së Kulturës së Kosovës, projektet e konservimit kryhen nga ekspertë të trashëgimisë “me qëllim të ruajtjes së autenticitetit historik dhe kujtesës kolektive.”

Ministria tha se Agjencia për Mbrojtjen e Monumenteve ka konservuar ose trajtuar disa shtëpi të lidhura me krime lufte, përfshirë shtëpi të lidhura me masakrat në fshatrat Likoshan, Poklek dhe Reçak.



Në fshatin Poklek, 53 civilë u vranë në shtëpinë e Fadil Muqollit më 17.04.1999. 51 nga viktimat u ekzekutuan brenda shtëpisë, ku trupat e tyre u dogjën disa herë. Mes viktimave kishte gra shtatzëna dhe 23 fëmijë, nga gjashtë muajsh deri në 14 vjeç, ndërsa viktima më e moshuar ishte 75 vjeç.

Shtëpia në Poklek është shndërruar në muze memorial. Ajo përmban fotografi, rroba, libra, fletore shkollore dhe sende personale të viktimave.

Zyrtarët theksojnë se procesi është shumë më i ndërlikuar për shkak se disa shtëpi ende janë të banuara nga të mbijetuar ose familjarë të viktimave.

“Një nga sfidat kryesore të ruajtjes dhe memorializimit të këtyre shtëpive mbetet fakti se disa prej tyre ende përdoren si banesa”- theksoi ministria, duke shtuar se “në raste të caktuara kemi hasur mospajtime nga anëtarët e familjes lidhur me mënyrën se si duhet të trajtohen objektet.”

“Divan plot vrima plumbash”: Kur shtëpia është edhe skenë e krimit të luftës

“Jetojmë në hijen e krimeve”



Ndryshe nga familja Gërxhaliu, shtëpia e së cilës po shkon drejt shndërrimit në muze, shumë familje ende vazhdojnë të jetojnë në prona ku dikur ndodhën vrasje. Përtej të qenit shtëpi, këto vende janë dëshmi të krimeve të luftës.

Në Gjakovë, Pranvera Sharani dhe katër fëmijët e saj kaluan vite duke fjetur në të njëjtën shtëpi, oborri i së cilës ishte vendi i ekzekutimit të 11 anëtarëve të familjes dhe fqinjëve të tyre në maj 1999.

“Kam mendu mu largu qysh ditën e parë”- tha ajo, duke parë drejt oborrit. “A pe sheh këtë oborr? Të gjithë i rreshtuan këtu. Nganjëherë kur mërzitem, them: ‘Po ecim mbi gjakun e tyre.’ Ende nuk e di si fle këtu. Jetojmë në hijen e krimeve”- tha ajo, teksa kujtonte si i kishte parë familjarët e saj dhe burra të tjerë të lagjes të rreshtuar nga forcat serbe.

“I pashë të rreshtuar”- kujtoi ajo. “Policia më patën tërheq zvarrë, duke më pyet ku ishin paratë. Kur dola përsëri, i pashë pranë murit. Derisa po largohesha, i dëgjova krismat e armëve.”

Tri ditë më vonë, ajo u kthye në zonë me disa fqinjë.

“E kemi pa një kamion të mbeturinave komunale që bartte trupat. Një kojshike madje i njohu rrobat e burrit të saj.”

Më 10.05.1999, gjashtë anëtarë të familjes Sharani u vranë, përfshirë burrin e saj Tahirin, 43 vjeç atëkohë, kunetërit Skyfterin, Mentorin dhe Isufin, si dhe dy nipër. Pesë burra nga familjet fqinje gjithashtu u mblodhën dhe u ekzekutuan në oborrin e tyre.

“Divan plot vrima plumbash”: Kur shtëpia është edhe skenë e krimit të luftës

Duke treguar një fotografi të saj me burrin Tahirin, Sharani ndaloi për një çast. “Burri im… jeta jem”- tha ajo.

Kunata e Pranverës, Luljeta, jeton ngjitur, duke ndarë të njëjtin oborr. Luljeta humbi burrin e saj Skyfterin, 48 vjeç atëkohë, dhe dy djemtë e tyre, Valonin 22-vjeçar dhe Visarin 20-vjeçar.

“Kur ushtria hyri, u thashë djemve të fshiheshin”- kujtoi Luljeta në një intervistë për dokumentarin e BIRN-it mbi personat e zhdukur, transmetuar më 16.05.2026.

“Valoni më tha: ‘Ku të fshihemi moj mam? E gjithë lagjja është e rrethuar.’ Kur na nxorën jashtë me forcë, ndaluan 11 burra, ndërsa grave dhe fëmijëve iu urdhërua të largoheshin”- tha ajo.

Anëtarët e familjes Sharani të vrarë nga forcat serbe më 10 maj 1999. Foto: BIRN

Luljeta thotë se familja kaloi vite pa e ditur ku ishin dërguar trupat, duke protestuar vazhdimisht derisa u gjetën në varrezën masive të Batajnicës në Serbi, së bashku me më shumë se 700 trupa të burrave, grave dhe fëmijëve shqiptarë të Kosovës, të transportuar nga vende të ndryshme të Kosovës.

“Më 23 dhjetor 2003 filluan kthimin e trupave në arkivole”- tha ajo.

“Trupi i kunatit tim Tahiri u kthye me grupin e parë. Katër muaj më vonë, më 18 prill 2004, kthyen grupin e dytë, ku ishin Skyfteri, Mentori dhe Isufi.” Rreth tre vjet më vonë, më 15 janar 2007, “që ishte edhe ditëlindja e Visarit, m’i kthyen djemtë.”

Pranvera ishte kthyer me katër fëmijët e saj, të moshës nga 7 deri në 14 vjeç, dhe më vonë bëri disa renovime në shtëpi pasi ajo ishte djegur. Në vitin 2002, ajo u zhvendos me fëmijët në Prishtinë, ku punoi si mësuese historie në një shkollë fillore.

“Shkolla dhe nxënësit ishin shpëtimi im”- tha ajo.

Dy vjet më parë, pasi doli në pension, ajo u kthye sërish në Gjakovë, në të njëjtën shtëpi.

“Sofa Full of Bullet Holes”: Kosovo Families Living in War Crime Scenes

“Është e dhimbshme të jetosh në një vend ku dikur kishe një jetë të mirë, e pastaj për pesë minuta gjithçka ndryshoi.”
Sot, ajo pendohet që e rinovoi shtëpinë:
“Mendoj se nuk duhej ta kishim rinovuar kurrë. Duhej të kishte mbetur ashtu siç ishte, si dëshmi e luftës.”

Trauma mbetet brenda mureve

Nga instalacioni “Mendoj për ty” i artistes Alketa Xhafa-Mripa, kushtuar viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, 2015
Për shumë të mbijetuar, dhuna e lidhur me shtëpitë e tyre shkoi përtej vrasjeve të të dashurve, megjithatë shumë prej tyre nuk morën kurrë mbështetjen e nevojshme për shëndetin mendor.
Pranvera Sharani tha se si të mbijetuar të krimeve të luftës “nuk kemi pasur as psikologë, pavarësisht gjithë traumës. Shëndeti mendor nuk diskutohej shumë në atë kohë. Trauma u transmetua edhe te fëmijët, sepse panë skena dhe abuzime të tmerrshme.”



Ajo kujton se kishte marrë djalin e saj të madh (17 vjeç atë kohë) me vete kur i’u kërkua të identifikonte mbetjet e burrit në një morg në Rahovec.
“Kam bo gabim. I ka ndiku shumë”- tha ajo.
Ndërkohë, vajza e saj ende e ka të vështirë të qëndrojë në shtëpi.
“Sa herë që vjen, më thotë: ‘Mam, nuk mundem me nejt këtu. Nuk mund të jetosh në këtë shtëpi.’ Dhe edhe për ne të tjerët, nuk është se qëndrojmë këtu me qelf, po të kishim ku të shkonim tjetër.”
“Edhe sot, kur shoh vetura policie, më kap një lloj ankthi.”
Përveç vrasjeve, dhuna seksuale dhe përdhunimet u kryen gjithashtu brenda shtëpive në gjithë Kosovën, dhe shumë gra u detyruan të vazhdonin të jetonin brenda atyre mureve.
Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarëve të Torturës (QKRMT) tha se shumë të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës ende jetojnë në shtëpitë ku ndodhi abuzimi seksual, shpesh sepse vështirësitë ekonomike nuk u lënë alternativë tjetër.

“Divan plot vrima plumbash”: Kur shtëpia është edhe skenë e krimit të luftës

“Në këto situata, shtëpia shpesh mbetet njëkohësisht vend i jetës së përditshme dhe një kujtesë e vazhdueshme e traumës. Kjo mund të shkaktojë emocione të dhimbshme, ankth dhe ndjenja pasigurie”- shpjegoi organizata, duke shtuar se me mbështetje profesionale, të mbijetuarit mund të rindërtojnë gradualisht ndjenjën e sigurisë brenda të njëjtës hapësirë.



“Kur është klinikisht e përshtatshme dhe pas stabilizimit të mjaftueshëm, qasjet e bazuara në ekspozim mund t’i ndihmojnë të mbijetuarit ta shohin shtëpinë ndryshe. Qëllimi është të ndahet e kaluara traumatike nga realiteti i tanishëm dhe gradualisht të shndërrohet shtëpia nga simbol rreziku në një hapësirë rikuperimi dhe jete”- tha QKRMT.

Shtëpia në fshatin Studime, Vushtrri, ku familja Gërxhaliu u vra nga forcat serbe më 31 maj 1999. Foto: BIRN

Për Gërxhaliun, megjithatë, kufiri mes kujtesës dhe jetës së përditshme nuk është zhdukur kurrë.

Duke mbajtur në dorë një libër që dokumenton vrasjet, ai pa sërish fotografitë e vendosura mbi shtretër.

“Pjesa më e vështirë”- tha ai, “është kur vij këtu dhe i shikoj këto fotografi.”

“Kur i hap ato dyer atje poshtë”- shtoi ai, “më duket sikur ende i shoh fëmijët ashtu si i pata lënë.”

Vegëza e plotë e artikullit në gjuhën shqipe: https://kallxo.com/gjate/reportazh/divan-plot-vrima-plumbash-kur-shtepia-eshte-edhe-skene-e-krimit-te-luftes/

Vegëza e plotë e artikullit në gjuhën angleze: https://prishtinainsight.com/sofa-full-of-bullet-holes-kosovo-families-living-in-war-crime-scenes-mag/

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Besian Beha

Baza e të dhënave me statistika të sakta për viktimat nga lufta e fundit në Kosovë, bashkë me të pagjeturit, pritet të finalizohet brenda këtij viti.

Kështu është shprehur drejtori i Institutit për Krime të Luftës, Atdhe Hetemi.

Ai ka deklaruar se pas finalizimit të databzës për viktimat dhe të pagjeturit, është në proces gjithashtu edhe hartimi i asaj për evidentimin e të gjitha masakrave në Kosovë. Deri më tash janë evidentuar 27 të tilla, dhe puna është në proces.

"Për neve është shumë e rëndësishme me pas një databazë që tregon sa ka qenë numri i njerëzve të vdekur, qoftë si viktima, apo që kanë humbur jetën në forma të tjera. Besoj që kjo databazë do të lansohet këtë vit. Databaza tjetër që është shumë e rëndësishme që lidhet me viktimat, është databaza e masakrave. Jemi duke punuar", është shprehur drejtori i Institutit.

Hetemi ka bërë të ditur se Instituti për Krime të Luftës deri më tash ka arritur të grumbullojë mbi 400 metra material fizik arkivor, mbi 18 mijë orë video-incizime që dëshmojnë për krimet e luftës, dhe mbi 1 milion fotografi.

"Instituti i Krimeve të Luftës sot është kthyer në adresë të besueshme për njerëzit që posedojnë dëshmi", është shprehur Hetemi gjatë intervistës.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Intervista e plotë:

Z.Hetemi, fillimisht, nëse mund të na përshkruani rikrijimin e Institutit për Krime të Luftës, duke qenë se ka qenë më herët një Institut i cili është shuar, dhe ka funksionuar si departament në Ministrinë e Drejtësisë?

Atdhe Hetemi: Instituti në formatin që është krijuar tani, është për herën e parë. Ka pasur inicativa institucionale në të kaluarën me u marrë me dokumentimin e krimeve të luftës, e njëra prej tyre ka qenë edhe Instituti i krijuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, i cili është themeluar nga një ministër i Drejtësisë, pra me vendimin e një ministri, ka funksionuar dikund 7 vite e gjysmë dhe pastaj është shuar, me anë të një vendimi tjetër të një ministri të Drejtësisë. Që i bie se nuk ka pasur një kornizë të duhur ligjore, dhe për rrjedhojë është mbyllur. Pastaj, Instituti për Krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, është i themeluar mbi bazën e ligjit në nëntor të vitit 2023, ku unë jam emëruar si Drejtor, me mandat për ta themeluar Institutin, mbi bazën që derivon nga ligji i aprovuar në Kuvend.

Ku është dallimi nga mënyra se si ka funksionuar Instituti për Krime të Luftës në të kaluarën, dhe si është tash?

Atdhe Hetemi: Instituti tash ka qëndrueshmërinë e vet financiare, pasi është i themeluar me ligj, ka linjën buxhetore me ligj, e ka kornizën e duhur ligjore, për shkak se e ka Ligjin e vet, rregulloren për funksionim të Institutit dhe sistematizim të vendeve të punës të nënshkruar nga kryeministri, pasi Instituti operon si agjenci e pavarur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Gjatë kësaj periudhe kohore, sa i përket kornizës ligjore kemi shfrytëzuar një mori rregulloresh, kemi pasuruar kogja shumë kornizën ligjore metodike dhe etike të punës. Paralelisht me fuqizimin e kësaj kornize, e kemi zhvilluar edhe infrastrukturën fizike të Institutit, pasi Instituti e ka zyrën e vet në Prishtinë, në objektin ku jemi aktualisht, në Agjencinë e Arkivave të Kosovës.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Këtu ekziston edhe depoja arkivore e Institutit, por përveç kësaj ka edhe gjashtë zyre rajonale, në të gjitha rajonet e Kosovës. I bie që infrastruktura jona fizike është zhvilluar në vazhdimësi përgjatë kësaj kohe prej që ekzistojmë, 2 vite e gjysmë. Në të njëjtën kohë, Instituti përveç kornizës ligjore, infrastrukturës, ne jemi pasuruar edhe me resurse njerëzore, pasi kemi rreth 40 punëtorë. Edhe pse me rregullore për sistematizimin e vendeve të punës Instituti parashihet të ketë 74 punonjës, gjatë këtij viti kemi pasur 46 të aprovuar me buxhet, shpresoj të jemi në gjendje ta rrisim këtë numër.

Drejtor, duke qenë se Instituti mori formën gati 24 vjet pas luftës, sa ka qenë e vështirë të fillojë puna nga zero, duke ditur sfidat që janë në dokumentin e krimeve të luftës?

Atdhe Hetemi: Nuk ka qenë proces i lehtë, akoma nuk është proces i lehtë fatkeqësisht. Megjithatë, fakti që ka pasur disa tendenca për dokumentimin e krimeve të luftës, nga paslufta, edhe pse kanë qenë të fragmentuara, na ka ndihmuar. Në kuptimin institucional ka pasur iniciativa, pastaj janë mbyllur, ka pasur tendenca nga organizatat e shoqërisë civile që janë marrë me dokumentimin e krimeve të luftës, një kontribut shumë të rëndësishëm e kanë dhënë edhe mediat. Gjatë kësaj kohe mediat kanë dhënë kontribut të madh në dokumentimin e krimeve të luftës përmes reportazheve, mbledhjeve të materialeve që kanë ekzistuar në kohën atëherë. Ajo që kemi bërë, sfida e parë ka qenë me kthy besimin te familjarët e viktimave, ose tek të mbijetuarit, në institucione shtetërore. Kur iu afroheshim njerëzve për të kërkuar dëshmi ose materiale, dhe u thoje që je institucion shtetëror në dokumentimin e krimeve të luftës, reagimet e tyre ishin se shteti nuk ka arritur ta bëjë këtë në formën e duhur deri më tash, pse duhet t'i besojmë këtij Instituti. Për shkak se qytetarët, viktimat e mbijetuara, familjarët, jo domosdoshmërisht e dinin se kemi kornizë tjetër ligjore.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Sfida e dytë ka qenë inicimi i bashkëpunimit me të gjithë akterët që kanë kontribuar në dokumentimin e krimeve të luftës, dhe bërja e qartë se qëllimi i Institutit është që të shërbejë si pikë grumbullimi, ku të gjithë ata që kanë materiale t'i dorëzojnë në Institut, e më pas të shërbejë si pikë referimi që të gjithë atyre që iu duhen ato materiale të vijnë në Institut, qoftë për punime të ndryshme akademike, shkrime gazetareske, apo produkte që mund të jenë filmat-dokumentar, artistik, dramat teatrale, ekspozitat e kështu me radhë. Mendoj se me gjithë këto sfida, Instituti ka arritur që të konsolidohet në institucion i cili ka tërhequr vëmendjen e të mbijetuarëve, ka tërhequr bashkëpunimin e familjarëve të viktimave, shoqërisë civile, institucioneve, mediave.

Ka pasur një progres modest, që nuk ka ardhur domosdoshmërisht vetëm si rezultat i angazhimit të punëtorëve të Institutit, edhe pse angazhimi nuk ka munguar. Unë jam dëshmitar, dhe e kam parë këtë gjë. Ka ardhur më shumë si rezultat i mbështetjes që kemi marrë nga institucionet qendrore, qeveria e Kosovës, komunat, sepse Instituti ka mbledhur materiale nga 33 komuna. Nën tre nga të mbijetuarit, familjarët, mediave, organizatave të shoqërisë civile, koleksionues, individëve që janë marrë me dokumentim. Ka qenë bashkëpunim i gjithanshëm që ka rezultuar me frytet e veta, që sot ta kemi një institucion shtetëror që ka kornizën e vet ligjore, metodike e etike, ka zyret e veta të shëprndara në krejt rajonet e Kosovës, ka bashkëpunim me institucione vendore e ndërkombëtare. Ka arritur të ketë publikime shkencore. Kemi pasur ekspozita, kemi ekspozu materialet video e foto-materialet në vende të ndryshme të botës. Kemi pasur bashkëpunim të frytshëm me ambasada e konsullata.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit



Për dikënd që është laik i kësaj fushe, cilat janë objektivat kryesore të Institutit, çka realisht bëni ju?

Atdhe Hetemi: E para, vlen të theksohet që Instituti i Krimeve të Luftës ka karakter dokumentues dhe hulumtues, jo hetues. Institucionet e drejtësisë merren me hetimin e krimeve të luftës. Instituti e ka për mision së pari dokumentimin e të gjitha krimeve të kryera gjatë luftës nga ana e regjimit të Jugosllavisë, të kryera në Kosovë. Kemi mandat për dokumentimin e krimeve të kryera kundër njerëzimit, krimeve ekonomike, psiko-sociale, krimet të shkaktuara në ambient, krimet ndaj trashëgimisë kulturore e shpirtërore. Por, misioni primar është dokumentimi i krimeve të shkaktuara nga Serbia në Kosovë. E dyta, mendoj që është shumë e rëndësishme si Institut ta dokumentojmë rezistencën të cilën shoqëria kosovare përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo rezistencën civile gjatë viteve 90-ta, e ka bërë karshi një regjimi barbar.

Me dokumentu edhe këtë rezistencë. Dhe e treta, shumë e rëndësishme për neve si Kosovë ta dokumentojmë edhe qasjen humanitare, solidarizimin e të tjerëve, miqve të Kosovës gjatë viteve të 90-ta. Mbështetjen e akterëve ndërkombëtarë për me ndalë eskalimin e gjenocidit që ka ndodhur. Humanizimin dhe solidarizimin që qytetarët e vendeve fqinje, si me shqiptarët në Maqedoni, Mal të Zi e Shqipëri, e kanë pasur karshi të dëbuarve, pra refugjatëve, edhe ky është element shumë i rëndësishëm sepse i kontribuon raporteve ndërfqinjësore, edhe i kontribuon të vërtetës historike të cilën ne si vend nuk duhet ta harrojë, duhet ta ruajmë me zell.

Një element tjetër me rëndësi që është një prej të arriturave e Instituti, është se metodologjia që ne po përdorim për dokumentimin e krimeve të luftës, po përdoret edhe nga vendet e tjera në post-konflikt, kemi pasur delegacion nga ana e shtetit të Ukrainës, metodologjia jonë po aplikohet

edhe në vendet e Evropës Qendrore që posedojnë Institute për dokumentimin e krimeve të komunizmit. Kjo është satisfaksion për neve, pasi Kosova nga një vend që ka përfituar nga ekspertizat e të tjerëve, jemi në situatë, ku kontribuojmë në dokumentimin e krimeve të luftës. Dhe dokumentimi është bazë për një paqe të qëndrueshme.

Deri më tash, materialet e krimeve të luftës kanë qenë në duart e personave individualë, gazetarëve, foto-reporterëve, apo persona privat. Si kontaktoni, a vetofrohen njerëzit duke e ditur funksionimin e Instituti, i thërrisni, apo si e ndërtoni raportin me ta?

Atdhe Hetemi: Në fillim, kjo ka qenë prej sfidave kryesore, jemi ofruar ne gjithmonë. Në bazë të metodologjisë që e aplikon Instituti për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të luftës, janë të parapara të gjitha hapat, është si një lloj manuali ku janë të parapara të gjitha hapat. Parashihet identifikimi i burimit, afrimi te burimi, kontakti me burimin, informatat që duhet t'i ketë secili person për punën e Institutit, dhe fondin arkivor që e krijojmë në emër të burimit, për të treguar respekt dhe konsideratë për të gjithë ata që kanë mbledhur materiale kur nuk kemi pasur institucione. Deri më tani kemi 1 mijë e 37 apo 38 burime që nënkupton individë, institucione, mediume, organizata. Çdo material që është futur në Institut, ne kemi krijuar fond arkivor në emër të burimit që e ka pasur materialin, për të treguar konsideratë për ata që edhe në të ardhmen kushdo që përdorë atë burim, thotë arkivi i Instituti, puna e filan fistekut.

Kjo është mënyra qysh qasemi. Në fillim kam pasur raste, kur kam dalë vetë në terren, tash kemi më shumë zyrtarë por dalë edhe tash, megjithatë zyrtarët kanë kontakte më të rregullta. Mua më kanë përzënë njerëzit prej shtëpisë, në filan fshatin, më kanë thënë na vjen keq, nuk iu besojmë iniciativave të tilla, ma lironi oborrin. Edhe ne sigurisht e kemi respektuar, sepse familjarët kanë të drejtë, kanë qenë të irrituar. Kemi njoftu se çka bëjmë nëse na ka dhënë mundësinë.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

E tash ka shpesh raste, më gëzon ky fakt, është ngritur besueshmëria karshi Institutit, ka raste kur vijnë njerëzit kemi dëgju kështu-kështu, dhe po duam t'i dorëzojmë këto materiale, sepse e dimë që Instituti përveç obligimit ligjor që e ka me i ruajt ato materiale e me i trajtu si duhet, e ka edhe infrastrukturën fizike më adekuate. Arkivi jonë plotëson të gjitha standardet ndërkombëtare sa i përket sigurisë fizike kundër zjarrit, kundër ujit, kundër insekteve.



Pra, po thoni që në Institut ka më pak rrezik që këto materiale me u dëmtu në forma të ndryshme?

Atdhe Hetemi: Rreziku është inekzistent, për shkak të përgjegjësisë e obligimit ligjor që ka Instituti. Njeriu krijon edhe lidhje emocionale me materialin, kur ka të bëjë me materiale të rralla për krimet e luftës, kërkohet një besim i madh me dorëzu materiale personale në një institucion. Krejt materialet e mia që kam pasur, i kam dorëzuar në Institut. E kemi infrastrukturën fizike më të mirë e më të duhur, se sa mund ta kemi në shtëpitë tona, apo bibliotekat tona. Për këtë rast, shumë foto-reporter shumë kameramanë, që kanë pasur materiale, sepse ai është material i ndjeshëm ai filmi i aparatit është dorëzu në Institut për shkak të sigurisë që kemi, për mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre.

Sa është sasia e materialeve që posedon Instituti deri më tash? Video-incizime, fotografi, dokumentacion, çkado që posedoni.

Atdhe Hetemi: Pa dashur të bëjë analiza krahasimore, për të treguar superioritet. Duhet me tregu që me u vërejt puna e Institutit. Gjatë 7 viteve e gjysmë sa ka ekzistuar Instituti në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë janë mbledhur vetëm 12 metra material filmik-arkivor që dokumenton krimet e luftës, ato 12 metra i kemi trashëguar, dhe i kemi sjellur këtu. Ndërsa, gjatë dy viteve Instituti aktual ka mbi 405 metra material fizik-arkivor, të arkivuar në arkivën e Institutit për momentin. Ky material është mbledhur nga më shumë se 1 mijë e 37 burime të ndryshme, prej 15 shteteve. Ky është materiali fizik. Materiali digjital Instituti paraprak ka pasur zero, ne kemi mbi 21 terabajt material digjital në arkviat e Institutit.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Me numra i bjen mbi 18 mijë orë video-incizime që dokumentojnë krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, mund të jenë më shumë se 1 milion fotografi. Kur po flasim për video-incizime e fotografi, është fjala për të ndryshme. Ka video-incizime që dëshmojnë fakte të masakrave, incizime për shkatërrimin e infrastrukturës, dëbime e kështu me radhë.



A ka raste që njerëzit ende kanë dilema me ofru materialin?

Atdhe Hetemi: Me thënë të drejtën unë edhe i arsyetoj. Mund të tingëllojë pak e vrazhdë e thënë nga ana ime, por ne duhet të punojmë shumë më shumë për t'i bindur se kjo është adresa dhe vendi i duhur. Këtë e bëjmë me punën dhe angazhimin tonë. Dyshimi i tyre është i arsyeshëm. Ka raste sigurisht, unë shpresoj që këto raste janë në rënie, që për arsye të dyshimit që kanë, ka raste që njerëzit për arsye sepse kërkojnë kompensim e ne nuk kemi mundësi, nuk e kemi të paraprarë buxhet, ka raste që nuk i dorëzojnë sepse mendojnë që kjo i bën ata më special kur e posedojnë vetëm ata një material. Ka raste që nuk dorëzojnë sepse duan të shkruajnë libra me atë material që e kanë. Ne si Institut, në atë procesverbalin që e kemi e kemi lënë një disclaimer edhe dhuruesve të materialeve ua kemi krijaur mundësinë që nëse ata duan ta dorëzojnë materialin vetëm për ta ruajtur, sepse shteti e ka obligim me ta ruajtë atë material, ata e kanë të drejtën të thonë që materialin po e dorëzojnë për ruajtje, dhe askush nuk mund ta përdorë këtë material pa leje paraprake prej anës së tij.

Ne kemi raste me foto-reporter që thotë t'i dorëzojë materialet, ti e ke obligim me mi ruajt sepse janë me interes shtetëror, po nuk guxon askush me përdorë këtë fond pa leje prej anës time. Edhe ne obligohemi me u pajtu, e marrim fondin e atij personi, e ruajmë në arkivë, kushdo që kërkon qasje në atë fond, e vendosim në kontakt me burimin, e pyesim a na jep leje për personin që po kërkon qasje për hulumtim.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Dhe ai referencohet. Ne jemi munduar me kriju komoditet e kushte sa më të mira për të gjithë dhuruesit e materialeve. Në vazhdimësi kemi pasur progres në krijimin e raporteve njerëzore, profesionale. Dokumentimi i krimeve të luftës, unë e kam kuptuar që nuk është vetëm proces administrativ apo akademik, është shumë më shumë human e njerëzor. Jemi munduar me kriju kushte përveç administrative e fizike, jemi munduar me kriju edhe raporte humane me njerëz.



Një temë tjetër drejtor. Fakti i statistikave zyrtare, për njerëz të vrarë, dëshmorë, martirë. Këto lloj statistikash, një data-bazë me e gjerë që deri më tash nuk ekziston, a është edhe kjo nën detyrën e Institutit për Krime të Luftës, sepse kanë kaluar 27 vjet nga lufta, dhe Kosova nuk e ka një data-bazë që mund të përdoret me këto të dhëna?

Atdhe Hetemi: Është, dhe jemi duke punuar intensivisht në këtë drejtim tash e 15 muaj. Por, në mungesë të këtyre të dhënave është dashur për neve të krijojmë një prioritizim, një strategji afat-mesme, çka me bë përpara. Përveç që nuk ka pas kurgjë, më është dukur e padrejtë dhe e ngutshme, kjo tendenca që krejt ato që kanë mungu për 28 vjet, barra me iu mbet Institutit që është hap që dy vjet, por njerëzit, mediat, kanë të drejtë me pas pritjet e tyre, se kanë prit mjaftueshëm. Prioriteti që kam bërë është që e para me kriju data-bazën për viktimat, ata që janë vrarë në luftë, ata që kanë humbur jetën si pasojë e plagëve dhe rrethanave në luftë,dhe ata që janë të pagjetur. Për këto tri kategori po punojmë në këtë data-bazë, është në proces të finalizmit, dhe shpresoj që këtë vit do të lansohet, apo do të jetë gati.

Si po i siguroni të dhënat, sepse ka kaluar kohë e gjatë, dhe të dhënat që kanë qenë deri më tash nuk kanë qenë zyrtare e institucionale?

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Atdhe Hetemi: Në njërën anë kemi pasur presion e obligim me gjetë të dhënat, e në anën tjetër kemi pasur një sfidë për me kriju të dhëna kredibile. Si rezultat, ajo që kemi vendosur me bë është që për secilën viktimë, që dokumentohet se ka qenë viktimë e luftës, të kemi minimum 8 burime që e vërtetojnë një gjë të tillë. Në kushtet normale, ose në datat-bazat e tjera, kanë mjaftuar tri burime me konstatu që kjo është viktimë. Ne kemi zgjedhur me i pas 8 burime. Tash çka nënkupton një burim. Burim mund të jetë data-baza e Fondit për të Drejtën Humanitare, burim mund të jetë një libër i një profesori, burim mund të jetë data-baza e krijuar nga KMLDNj, burim mund të jetë edhe ndonjë autor i ndonjë libri të ndonjë masakre në ndonjë fshat, ne kemi përdorur edhe burime shtesë.

Të dhënat që dalin nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, të dhëna nga Agjencia e Regjistrimit Civil, certifikatat e vdekjes, kemi përdorur video-material, audio-material, fotografi për raste të caktuara, dëshmi ose konfirmime nga ana e familjarëve, jemi munduar me qenë sa më të sigurt duke përdorur sa më shumë burime për secilën viktimë, sepse kjo është shumë e rëndësishme. Kjo data-bazë, shpresoj se do të lansohet gjatë këtij viti. Kemi bashkëpunuar me individë, organizata që janë marrë me këtë punë gjatë kësaj periudhe. Ideja nuk është me nxjerr diçka vet, po bashkërisht, që me marrë formën e data-bazës shtetërore.

Pra, nëse e bëjmë një përshkrim, databaza do ta ketë emrin, mbiemrin, komunën, mënyrën e vrasjes, ose mënyrën e vdekjes, konfirmime të tilla a është dëshmor, apo martir?

Atdhe Hetemi: Në këtë fazë, kemi bërë tri kategorizime. I vrarë, i vdekur si pasojë e plagëve apo rrethanave të luftës. Ka mundur të jetë dikush i plagosur në Prizren, e është dërguar në Shqipëri ka vdekur atje. Dhe e treta, kategoria për të pagjeturit. Më vonë, gjatë procesit, ne duhet ta bëjmë kategorizimin e mëtutjeshëm, kush është martir, kush hero.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Për neve është shumë e rëndësishme me pas një databazë që tregon sa ka qenë numri i njerëzve të vdekur, qoftë si viktima, apo që kanë humbur jetën në forma të tjera. Ka pasur raste që kanë vdekur nëna gjatë lindjes për mungesë të kushteve, ajo konsiderohet si viktimë e luftës. Databaza tjetër që është shumë e rëndësishme që lidhet me viktimat, është databaza e masakrave. Jemi duke punuar, deri më tani kemi të përfshirë 27 masakra, kjo është punë në proces. Prioritetin kryesor e kemi pasur te databaza e viktimave, sapo të përfundohet kjo, do të kalojmë tek ajo e masakrave. Dhe databaza e tretë është ajo e varrezave masive, në momentin që i kemi këto tri databaza, hapet rrugë për databaza të tjera për viktimat gjatë rezistencës, databaza e nxënësëve të helmuar gjatë viteve 90-,ta databaza e të burgosurve politikë, databaza e objekteve të shkatërruara të infrastrukturës publike. Është prioritare në këtë fazë ajo për viktima e masakrave, viktimave dhe varrezave masive, sepse këto kanë të bëjnë direkt me krimet kundër njerëzimet.

Arsyeja pse u ndala këtu është shkaku i ekspozitës në shesh që nxiti shumë reagime. A është mungesa e një databaze arsyeja që mund të shkaktojë kaq shumë reagime, dhe a iu ka dëmtuar si Institut duke qenë direkt në pjesëmarrje të dokumentimit të krimeve të luftës?

Atdhe Hetemi: Instituti e ka prioritet me përdorë një metodologji kredibile, mbi bazën e së cilës ndërton databazat e veta. Iniciativat individuale e të organizatave mbesin në përgjegjësinë e tyre, dhe nuk besoj se e dëmtojnë kredibilitetin e Institutit. Atë e vendos metodologjia që e përdorim, bashkëpunimi me të tjerë. Nuk po e shoh me interes të komentoj.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

A ka qenë ajo ekspozitë dëshmi në mënyrën se si interpretohen të dhënat e luftës, duke qenë se ballafaqimi me të kaluarën është proces i ndjeshëm?

Atdhe Hetemi: Mostrajtimi i këtyre shifrave, apo i këtyre historive, eventeve me ndjeshmëri, jo vetëm akademike, por humane, mund potencialisht të ndikojë në ritraumatizimin e të mbijetuarëve dhe familjarët e tyre. Përveç qasjes profesionale, duhet të këmi edhe qasje njerëzore. Pa këtë kombinatorikë, mendoj mund të bëjmë gabime që kanë efekt.

Ka qenë si diskutim padia për gjenocid, dhe ju thatë që Instituti nuk heton por dokumenton. A mund të përdoren të dhënat e Institutit, nëse shteti synon të hartojë padi të tillë?

Atdhe Hetemi: Instituti nuk ka mandat hetues. Janë tri shtylla megjithatë, përmes të cilave Instituti mundohet t'i shërbejë shoqërisë dhe të vërtetës historike. Nën një, është shtylla edukativo-arsimore, përmes këtyre institucioneve ne krijojmë qasje në të dhënat tona, në mënyrë që ta ngrisim vetëdijen e shoqërisë për krimet e kryera gjatë luftës, për rezistencën e popullit të Kosovës, dhe lidhjen me humanizmin e solidaritetin që të tjerët e kanë shfaqur në raport me Kosovën. Kemi pasur progres, kemi organizuar konferenca shkencore, e bashkëpunime me ministri të Arsimit e Bibliotekën Kombëtare, përmes ekspozitave kemi përçuar mesazhin tonë.

Nën dy, bashkëpunimi me institucionet e kulturës. Kemi ftuar producentë, dramaturgë, artistë, me i përdorë të dhënat e institutit që me i bo produktet e tyre aritistike, filma, ekspozita përmes fotografive e video-materialeve, në mënyrë që të kontribuojmë në vetëdijen e shoqërisë për të vërtetën historike. Dhe nën tre bashkëpunim me institucionet e drejtësisë. Kemi obligim me bashkëpunu me institucionet e drejtësisë.

Atdhe Hetemi: Brenda vitit e finalizojmë databazën zyrtare për viktimat e luftës dhe të pagjeturit

Mirëpo natyra është kështu: ata janë duke hetuar një rast, dhe ata bëjnë kërkesë a keni informacion për rastin X ose Y, ne mbledhim të gjitha materialet ua dorëzojmë atyre, njëjtë si ua dorëzojmë akademikëve, apo producentëve, apo në ekspozita, dhe ata e shfrytëzojnë atë material. Nëse një padi për gjenocid mund të ndodhë, materialet që posedojmë, jemi të obliguar t'i ndajmë me këdo që ka përgjegjësi.

Vegëza e plotë në gjuhën shqipe: https://telegrafi.com/atdhe-hetemi-brenda-vitit-e-finalizojme-databazen-zyrtare-per-viktimat-e-luftes-dhe-te-pagjeturit/

“Edhe unë kam diçka në bark”- Shtatë vite jetë, 28 vite kujtim

Besnik Gashi

Në oborrin e shtëpisë së Ahmetëve në fshatin Rezallë të Komunës së Skenderajt, vrimat e granatës ende nuk janë mbyllur. Bahri Ahmeti thotë se i ka lënë ashtu qëllimisht, si dëshmi. Më 11 shtator të 1998-ës, aty u plagosën disa anëtarë të familjes dhe u vra Leutrim Ahmeti, shtatë vjeçar.

Ditën kur u vra Leutrimi, familja po përgatitej të largohej nga shtëpia. Ofensiva kishte filluar dhe granatat po binin shtëpi-më-shtëpi. Familjarët ishin porositur nga kryefamiljari, Malush Ahmeti, që në rast të ofenzivave të largoheshin menjëherë nga shtëpitë e tyre. Malush Ahmeti ndodhej në zona dyluftimi në malet e Rezallës. Nëna e Leutrimit po nxirrte gjëra nga shtëpia për t’i marrë me vete dhe për t’u larguar me anëtarë të tjerë të familjes me traktor.

Granata e parë vrau, Vjollcën 4 vjeçare, të cilën serbët e kishin varrosur në arën me misër, pak më larg shtëpisë, plagosi rëndë vajzën 18-vjeçare, Fatmire M. Ahmetin, plagosi Shpresa Ahmetin, Fatmire F. Ahmetin si dhe Brahim Ahmetin.

Ndërkaq, granata e dytë në oborrin e djalit të xhaxhait të Malush Ahmetit në traktorin që gjendej në oborr mbetën të vrarë: Ramadan Ahmeti, Elfije Ahmeti dhe Xufa Ahmeti, ndërkaq të plagosur mbetën Makfirete Ahmeti, Bajram Ahmeti dhe Tahir Lladrovci.

Leutrimi ndodhej në oborr, teksa nëna e tij po dilte nga dera e sallonit të shtëpisë.

Motra e tij, Fatmirja, u plagos nga copat e granatës.

“I ka shenjat hala, bile copat e granatës hala në kamë i ka”, rrëfen Bahri Ahmeti.

“Edhe unë kam diçka në bark”- Shtatë vite jetë, 28 vite kujtim

Për shkak të granatave të rëna në oborrin e familjes Ahmeti, ishin jo-funksionalizuar të gjitha mjetet transportuese në oborr. Leutrimi ishte nisur me nënën për dore në këmbë drejt shkollës, kur familja po përpiqej të largohej nga zona e granatimit.

“Hajde, hajde, gutu”, i kishte thënë nëna. Leutrimi ishte ndalur. “Oj nanë”, kishte thënë ai, rrëfen Bahriu, “ndal mos u ngut se edhe unë kam diçka në bark”. Kur nëna ia kishte ngritur xhemperin, kishte vërejtur se Leutrimi kishte marrë plagë nga granata në pjesën e barkut. “Tha veç nisën organet me i dalë jashtë”, thotë Bahriu, duke cituar fjalët e nënës së tij.

Leutrim Ahmeti dhe të tjerë të plagosur nga ofenziva ushtarake serbe në drejtim të civilëve ishin dërguar për në fshatin Likoc për dhënien e ndihmës së parë. Më pas, Leutrimi ishte dërguar në spitalin ushtarak të fshatit Gradicë.

Bahri Ahmeti, para momentit kritik, ndodhej në front lufte me babain e tij, Malush Ahmetin dhe Ahmet Zabelin.

“Baba më tha te koka bë diçka poshtë në oborr tonin”, rrëfen ai, teksa bën të ditur se s’ishin në dijeni për tragjedinë që kishte ndodhur për shkak të pamundësisë që t’i afroheshin shtëpisë së tyre.



Pasi ishte nisur në këmbë në drejtim të Polluzhës, Bahria kishte hipur në një veturë me të plagosur për të arritur në drejtim të Gradicës.

Bahria bën të ditur se ishte vëllai i tij, Bedriu, që i kishte treguar se vëllai tjetër, Leutrimi, kishte ndërruar jetë. Ai thotë se në ato çaste humbi vetëdijen dhe tentoi t’i merrte vetes jetën.

“Dola thashë “Bedri, çka u bë?”, tha “vallahi Leutrimi ka ndërru jetë”. Aty tani mu më ka hup vetëdija, s’kom dit çka kom ba. I kam kap siguresat e bumës, kom desht veten me e mbytë. Më kanë kap ata, m’i kanë hjek bumet, automatat krejt prej veti”, thotë Bahriu.

Sot, pas afro tri dekadash, familja ende ruan kujtimet e Leutrimit. Në shtëpi kanë mbetur fotografitë, atletet dhe çorapet e tij si kujtim. Bahriu thotë se e kujton Leutrimin si të hareshëm dhe inteligjent. Thotë se çdo cep i oborrit ia kujton vëllain.

“Kah ngajke, kah lujke me biciklet… krejt më kujtohet. Vetë gjakun e ka pasë me t’shti me e deshtë”, thotë Bahriu për Leutrimin.

“Edhe unë kam diçka në bark”- Shtatë vite jetë, 28 vite kujtim



Leutrim Ahmeti është djali i dëshmorit, Malush Ahmeti, i cili ishte pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Tetë muaj pas vrasjes së Leutrimit, si luftëtar kishte rënë babai i tij Malush Ahmeti. Trupi i Leutrimit fillimisht ishte varrosur në Gradicë, në pamundësi që ta sjellnin në Rezallë.

Familjarët kishin shfrytëzuar një armëpushim përgjatë luftës për ta bërë rivarrimin e Leutrimit në Rezallë, vendin e tij të lindjes. Bahriu kujton se si babai i tij, Malush Ahmeti, po i thoshte se po e sheh në ëndërr “duke thënë o babë hajde merrëm” para rivarrimit.

“Baba më thoshte nuk po mundem gjumin si gjumë me e bë, se po e shoh Leutrimin në ëndërr duke me thënë, “o babë, hajde merrum”. Kështu që baba tha “deri te bi Leutrimin në vend temin, gjumin si gjumë nuk po mundëm ta bëj”…. dhe e kemi pru e kemi varros [në Rezallë]”, rrëfen Bahriu.

Malushi kishte lënë amanet që të varroset pranë të birit të tij, Leutrimit. Sot trupi i tij pushon pranë të birit.

Varri i Malush dhe Leutrim Ahmetit pranë njëri-tjetrit në fshatin e lindjes, në Rezallë

Leutrimi para ofenzivës ushtarake serbe kishte filluar t’i vijonte mësimet në shkollën e fshatit, e cila sot mban emrin e babait të tij, Malush Ahmetit. Në pllakën përkujtimore, pranë emrit të Leotrimit si nxënës figurojnë edhe nxënës të tjerë të vrarë në luftë: Xufë dhe Elfie Ahmeti, Lulver Deliu dhe Burim Zabeli.

Po ashtu, në pllakën përkujtimore ku kanë mbetur të vrarë janë mësimdhënësit: Hajdin Aruqi, Isuf Aruqi, Isuf Rukolli dhe Tafil Kabashi, si dhe Rexhep Rukolli, punonjës teknik.

Në bazë të dhënave të Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë (HLC), nga më shumë se 13 mijë të vrarë gjatë luftës së fundit në Kosovë, mbi dhjetë mijë janë viktima civile. Prej tyre, mbi një mijë janë fëmijë.

“Edhe unë kam diçka në bark”- Shtatë vite jetë, 28 vite kujtim

Më 2019-ën, HLC kishte hapur një ekspozitë me emrin “Na ishte një herë që kurrë mos qoftë”, në kujtim të fëmijëve të vrarë gjatë luftës në Kosovë.

Krimet e kryera në Rezallë, gjykimi në mungesë dhe mungesa e drejtësisë

Në fshatin Rezallë të Skenderajt janë regjistruar 98 civilë të vrarë përgjatë luftës në Kosovë. Më 5 prill 1999 serbët i rrethuan shtëpitë e familjeve të fshatit Rrezallë dhe vranë 44 civilë shqiptarë, në një vend të vetëm.

Viktimat u ekzekutuan në kodrën e lartë, në hyrje të lagjes së kodrave, ku sot ndodhet përmendorja në nderim të viktimave të kësaj masakre. Trupat e viktimave shqiptare, sipas rrëfimit të banorëve përreth, ishin mbuluar me rërë duke u shtresëzuar dy herë dhe ishin dërguar në Rudnicë dhe Kizhevak. Kjo, për t’i fshehur gjurmët e krimeve.

Nga 54 viktimat e zhvarrosura, gjatë vitit 2014, në Rudnicë, mbetjet mortore të 29 prej tyre ishin të viktimave të masakrës së Rrezallës. Ndërsa nga varreza masive në Kizhevak, gjatë zhvarrimeve gjatë vitit 2021, ishin zhvarrosur mbetjet mortore edhe të viktimave tjera të masakrës së Rrezallës, pra edhe 7 viktimave.

Për gjetjen e të vrarëve në Rezallë dhe të Masakrës së Rezallës një punë të madhe e ka kryer edhe kryetari i fshatit Muhamet Rukolli, në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare, masakra e Rrezallës është kryer nga ish Ushtria Jugosllave (Brigada e Motorizuar 37, që e kishte bazën në Rashkë dhe njësitet tjera ushtarake dhe policore serbe).

Familjari i Ismet Rukollit, të vrarit në masakrën e Rrezallës, Rrustem Rukolli kishte ngritur aktpadi më 2016-ën në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës ndaj Dejan Randeloviqit, komandant i Brigadës së 37-të të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave dhe Ljubisha Dikoviqit, komandantin e atëhershëm të batalionit të dytë të së njëjtës brigadë, duke i bërë përgjegjës për këtë masakër.

“Edhe unë kam diçka në bark”- Shtatë vite jetë, 28 vite kujtim



Bahri Ahmeti thotë se as ai e as ndonjë pjesëtar i familjes të të vrarëve në Rrezallë nuk kanë marrë ndonjë thirrje nga organet e drejtësisë.

“Hala asnjë s’u dalë asnjë gjykatë, asnjë prokuror që me thanë me marrë dikë e me e gjyku… Dëshmi kemi, janë tre që i kanë shpëtu Masakrës së Rezallës. Njëri na u ka vra në luftë apet. Njëri Misim Deliu, deri para pesë gjashtë vjete edhe ai u dek nga natyra, shkaku i moshës. Është edhe një djal i Rukollëve, ai është ende gjallë”, deklaron Ahmeti.

Ndryshimet e miratuara në vitin 2021 në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës kanë mundësuar gjykimin në mungesë të krimeve të luftës. Kjo formë gjykimi zhvillohet pa prezencën e të akuzuarit.

Gjykimet në mungesë kryesisht po zhvillohen për shkak të pamundësisë që të akuzuarit për krimet lufte të sillen para trupit gjykues. Të akuzuarit që kanë kryer krime lufte në të shumtën e rasteve ndodhen në Serbi, shtet ky me të cilin Kosova nuk ka marrëveshje ekstradimi e as bashkëpunimi në fushën e drejtësisë.

Në fund të dhjetorit të 2025-ës, Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj 21 personave për masakrën në Reçak, kur u vranë 45 civilë më 15 janar 1999.

Vegëza e plotë e artikullit në gjuhën shqipe: https://insajderi.org/edhe-une-kam-dicka-ne-bark-shtate-vite-jete-28-vite-kujtim/

Minat serbe vazhdojnë të marrin jetë në Kosovë

Blerta Dalloshi Berisha

117 viktima pas përfundimit të luftës

Më 24 prill të vitit 1999, pesë fëmijë të familjes Koxha nga komuna e Kaçanikut humbën jetën afër lagjes së tyre pasi kishin rënë në një zonë të minuar nga forcat paramilitare serbe.

Më i madhi ishte 15 vjeç dhe më i vogli tre vjeç.

Babai i Edonit, Bekim Koxha, tregon se si nuk arriti të ishte në varrimin e djalit të tij, i cili ishte vetëm tre vjeç kur humbi jetën, pasi shërbente në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

"E kam marrë lajmin se ka ndodhur një eksplodim po në lagjen Koxhaj. Unë isha duke vepruar në lagjen Zhark, fshat i Biqecit, si ushtar i UÇK-së. Kur më erdhi informacioni u nisa për këtu. Rruga që më shpie në shtëpi kalon nga varrezat ku jemi. Menjëherë e dita që ka ndodhur diçka. E pashë që kishin varrosur pesë fëmijë, ku në mesin e tyre ishte edhe djali im. Kur shkova në shtëpi e kuptova se aty kishin vendosur mina dhe fëmijët kishin rënë në zonë të minuar", thotë Bekim Koxha për Tv Klan.

Pas përfundimit të luftës, forcat serbe kishin lënë shumë zona të minuara, përfshirë edhe në këtë komunë.

Vetëm 30 kilometra larg Kaçanikut, në zonën e Hanit të Elezit afër kufirit me Maqedoninë e Veriut, Hamdi Lika, që udhëheq ekipin e deminimit në organizatën për pastrimin e minave dhe fushëbetejave The Halo Trust, po vëzhgon punën e palodhur të deminerëve në një zonë e cila ende është e minuar. Ai rrëfen për Tv Klan se në këtë zonë kanë humbur jetën dy persona, njëri në vitin 2000 dhe tjetri në vitin 2006. Deri më tani janë pastruar 7,138 m².

"Metrat e caktuara në këtë poligon janë diku 7,883 m², kurse të pastruara janë 7,138 m² dhe si poligon shtesë, për shkak të minave të gjetura, janë shtuar edhe 13,313 m². Të gjeturat deri më tani në këtë fushë janë 8 PMA2 dhe 2 MPR2A".

Minat serbe vazhdojnë të marrin jetë në Kosovë

Pastrimi i kësaj zone parashihet të përfundojë më 2 shtator të këtij viti. Në qershor të vitit 1999, menjëherë pas luftës, janë identifikuar 4,520 zona të rrezikshme, bëjnë të ditur nga Ministria e Mbrojtjes.

“Nga ekipet e deminimit të organizatave të ndryshme dhe FSK-së deri më tash janë pastruar 66 milionë metra katrorë dhe janë demoluar mbi 96 mijë mina dhe mjete të tjera shpërthyese. Aktualisht janë 51 zona të rrezikshme, të cilat gjenden kryesisht në zona malore dhe kufitare”, thotë Ahmet Sallova, Drejtor i Qendrës Koordinuese për Deminim në Ministrinë e Mbrojtjes.

“Numri i personave që kanë humbur jetën kalon shifrën 100, ndërsa katërfish më i madh është numri i të lënduarve. Që nga paslufta, 117 persona kanë humbur jetën nga mjetet shpërthyese në zona të minuara, ndërsa 469 të tjerë janë lënduar”, shton Sallova.

Parashihet që deri në vitin 2030 të përfundojë pastrimi i gjithë territorit të Kosovës nga minat dhe mjetet e tjera shpërthyese të vendosura nga forcat serbe gjatë luftës së fundit në Kosovë.



Vegëza e plotë e artikullit dhe videos në gjuhën shqip: https://tvklan.al/minat-vazhdojne-te-marrin-jete-ne-kosove

Kërkoj shtëpinë time të humbur në Moravske

Fatmir Menekshe

“Lagje e romëve, por sot pa romë. Një kohë e mbushur, por sot e zbrazët. Një kohë që qeshte, tani po qan.”

Me këto fjalë e nis rrëfimin e tij Azir Jasari, gazetar dhe hulumtues rom nga Prishtina, i cili përmes kujtimeve personale rikthen historinë e lagjes Moravska – një prej lagjeve më të mëdha rome në kryeqytetin e Kosovës, e cila sot pothuajse nuk ekziston më siç ishte dikur.

Për Jasarin, Prishtina nuk është vetëm qyteti ku ka lindur dhe është rritur. Ajo është pjesë e kujtesës së tij personale dhe kolektive, një hapësirë që, sipas tij, është transformuar deri në atë pikë sa gjurmët e dikurshme të komunitetit rom mezi dallohen.

“Na i ndryshuan gjurmët, na e rrëzuan, na e shlyen, na e lyen dhe na e mbuluan me ngjyra të tjera”, thotë ai, duke përshkruar ndjenjën e humbjes së identitetit dhe të përkatësisë.

Një komunitet i madh në zemër të Prishtinës

Sipas të dhënave që sjell Jasari, para luftës në Kosovë, në Prishtinë dhe zonat përreth – përfshirë Fushë Kosovën, Graçanicën dhe disa fshatra të tjera – jetonin rreth 22 mijë romë. Komuniteti rom në Prishtinë ishte i përqendruar kryesisht në tri lagje: Moravska, Dalmatinska (Divanjolli) dhe Kolibarska. Vetëm në Moravske, e cila ndodhej prapa Teatrit të Qytetit, pak minuta larg qendrës së Prishtinës, jetonin afërsisht 10 mijë banorë.

“Krahas romëve jetonin edhe shqiptarë, serbë, turq dhe goranë. Jetonim si vëllezër. Nuk kishte konflikte mes nesh dhe jeta zhvillohej në frymë bashkëjetese”, kujton ai.

Komuniteti rom kishte zejtarë të njohur, intelektualë dhe njerëz të arsimuar. Jasari përmend edhe historinë e farkëtarit Sallqe, mjeshtër i njohur i hekurit, për të cilin thuhet se kishte punuar karrocën mbretërore të mbretit Aleksandër Karagjorgjeviq.

Kërkoj shtëpinë time të humbur në Moravskë

Nga margjinalizimi te emancipimi

Megjithëse kushtet infrastrukturore në lagjet rome ishin të vështira, me mungesë të ujit, kanalizimit dhe rrugëve të asfaltuara, vitet e tetëdhjeta shënuan një periudhë të rëndësishme emancipimi.

“Filloi një vrull më i madh i shkollimit të komunitetit rom. Gjithnjë kishte pasur të shkolluar, por atëherë numri i nxënësve dhe studentëve u rrit ndjeshëm”, kujton Jasari.

Sipas tij, falë një brezi intelektualësh romë, gjendja sociale dhe arsimore e komunitetit filloi të përmirësohej. Megjithatë, ky proces u ndërpre nga shpërthimi i luftës.



Një eksod për të cilin flitet pak

Jasari e përshkruan largimin e romëve nga Kosova si një nga tragjeditë më të mëdha dhe më pak të trajtuara pas luftës.

“Romet përbëjnë përqindjen më të madhe të të larguarve nga Kosova. Rreth 95 për qind e komunitetit u detyrua të largohej”, thotë ai.

Sipas tij, para luftës në Kosovë jetonin mes 150 dhe 200 mijë romë, ndërsa sot numri i tyre është shumë më i vogël.

Ai thekson se romët u gjendën mes dy zjarreve gjatë konfliktit.

“Njëra palë na konsideronte bashkëpunëtorë të serbëve, ndërsa pala tjetër, për shkak të emrave dhe religjionit, na konsideronte bashkëpunëtorë të shqiptarëve. Ne kërkonim vetëm të mbeteshim romë.”

Përpjekja për të qëndruar neutralë, sipas tij, ishte pothuajse e pamundur në rrethanat e luftës.

Frika, rrëmbimet dhe dhuna

Në rrëfimin e tij, Jasari flet për raste të shumta rrëmbimesh, zhdukjesh dhe dhune që, sipas tij, kanë mbetur të padokumentuara.

Ai kujton se persona të armatosur dhe me fytyra të mbuluara hynin në lagje, merrnin njerëz me forcë dhe më pas nuk dihej asgjë për fatin e tyre.

“Kemi pasur edhe raste të shumta të dhunës seksuale ndaj romëve, por ato nuk janë raportuar asnjëherë”, thotë ai.

Sipas Jasarit, komuniteti rom kërkonte mbrojtje nga forcat ndërkombëtare pas luftës, por ndihej i braktisur dhe i padëgjuar.

Kërkoj shtëpinë time të humbur në Moravskë

Fundi i Moravskes

Deri më 29 qershor 1999, Jasari qëndroi në Prishtinë me familjen e tij. Ai kujton ditët kur shihte se si familjet rome nxirreshin nga shtëpitë dhe pronat e tyre digjeshin.

“Çdo ditë iknin njerëz. Stacioni i autobusëve ishte plot. Në një autobus hipnin shumë më tepër njerëz sesa mund të mbante. Ishin pamje të rënda.”

Edhe vetë u largua me bashkëshorten dhe tre fëmijët.

“Ishte shumë e vështirë ta lëshoja shtëpinë. Gruaja më tha t’i marrim albumet me fotografi. I thashë jo, sepse do të kthehemi. Por ne nuk u kthyem më kurrë.”

Sot, nga e kaluara e tij në Prishtinë, ai ruan vetëm çelësat e shtëpisë dhe të zyrës.

“I mbaj ende me vete.”

Kujtesa kundër harresës

Sipas Jasarit, një pjesë e madhe e lagjes Moravska është shkatërruar ose transformuar plotësisht. Shumë ish-banorë nuk e shohin më të mundur kthimin, për shkak të mungesës së sigurisë dhe besimit.

Ai kritikon edhe mungesën e raportimit mediatik për fatin e komunitetit rom gjatë dhe pas luftës.

“Askush nuk na pyeti nëse donim të qëndronim apo të largoheshim. Askush nuk pyeti për problemet tona.”

Megjithatë, mesazhi i tij përfundimtar nuk është vetëm rrëfim i humbjes, por edhe përpjekje për të ruajtur kujtesën.

“Lagjet tona janë ndërtuar mbi gurë graniti. Kanë mbijetuar shumë luftëra dhe kanë rrënjë të thella. Aty janë varrezat e gjyshërve tanë. Ata do të flasin për ne. Ne jemi betuar se nuk do t’i harrojmë kurrë.”

Për Azir Jasarin, Moravska mund të mos ekzistojë më si dikur, por kujtesa për të vazhdon të mbetet një pjesë e pandashme e identitetit të një komuniteti që kërkon të mos harrohet. Historia e saj është një kujtesë se ballafaqimi me të kaluarën nuk mund të jetë i plotë pa dëgjuar edhe zërat që për dekada kanë mbetur në margjinat e historisë.

Vegëza e plotë e podcastit në gjuhën rome: https://www.youtube.com/watch?v=V1w0hOZLALQ

Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha

Fisnik Minci

Në qendër të Suharekës, mes zhurmës së zakonshme të qytetit të një dite maji, ndodhet edhe një hapësirë me qetësi të trishtë. Kjo qetësi tek vizitori krijon përshtypjen se aty, koha është ndalur përgjithmonë në pranverën e vitit 1999.

Dyert e vjetra të aluminit, të demoluara nga forca dhe të shpuara vende vende nga plumbat, mbeten ende në formën origjinale. Në mure ka gjurmë gjaku të zbehura nga vitet, por jo nga kujtesa. Në dysheme të lokalit, ka edhe gëzhoja plumbash që vazhdojnë të qëndrojnë aty ku ranë atë ditë të 26 marsit 1999, kur forcat serbe kryen njërën prej masakrave të rënda ndaj civilëve shqiptarë gjatë luftës në Kosovë, duke vrarë 49 anëtarë të familjes Berisha. Tre të tjerë falë fatit mbijetuan për t'i rrëfyer botës krimet e luftës të kryera në atë datë.

Kjo hapësirë te Qendra Tregtare në Suharekë, që dikur ishte Piceria "Kalabria", para pesë vitesh është shndërruar në Muzeun e Martirëve të Familjes Berisha, si një dëshmi e kujtesës kolektive, dhimbjes së pambyllur dhe përpjekjes për të mos lejuar harresën që të gjejë strehë.

Biberoni, fletoret dhe gëzhojat e plumbave

Ngjyra e paprekur e kahershme e mureve përzihet me heshtjen që mbizotëron brenda. Çdo fotografi, çdo objekt, çdo gjurmë e ruajtur mban një rrëfim të vetin. Ato janë të mbuluara me xhama falë një donacioni nga Fondacioni "Golden Eagle", njëjtë sikurse edhe dyshemeja në mes që i ngjan një vitrine vertikale, e ku me sy dallohet edhe një biberon fëmije. I heshtur, i zakonshëm në pamje, por i rëndë sa vetë historia që mbartë. Është një dëshmi e dhimbshme se në atë masakër nuk u kursyen as fëmijët.

Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha

Mbi këtë vitrinë, pak më tutje janë të ekspozuara kopjet e fletoreve shkollore, vizatimet dhe krijimet e fëmijëve të familjes Berisha. Në këto ekspozime ka edhe kopje të fletave me shkronja të pafajshme, nga detyra që ka marrë notën shkëlqyeshëm. Afër tyre ka fotografi të rrobave të viktimave, të gjetura pas zhvarrosjeve nga varrezat masive në Kosovë dhe Serbi, si tregues për ndërprerjen e parakohshme të ëndrrave dhe më shumë si dëshmi të një përpjekjeje sistematike për të fshehur krimin.

Në anën e majtë të hyrjes figurojnë emrat e viktimave të vrarë, derisa në anën e djathtë janë të shkruar emrat e tre të mbijetuarve: Shyhrete Berisha, Vjollca Berisha dhe Gramoz Berisha. "Engjuj që u kthyen nga vdekja për të rrëfyer trishtimin", shkruan aty.



"Krimi ndaj tyre ishte pesëfish"

Për këtë muze kujdeset çdo ditë Hysni Berisha, 72 vjeçar. Ai i pret vizitorët me mirësjellje, me një qetësi që fsheh lodhjen e viteve dhe barrën e kujtesës. Ecën ngadalë nëpër lokal, ndalet pranë fotografive, prek herë pas here ndonjë objekt dhe nis të rrëfejë, jo vetëm për atë që ndodhi me familjen Berisha, por edhe për përpjekjen e gjatë për të gjetur të zhdukurit dhe për të ruajtur të vërtetën.

"Të gjitha krimet që janë bërë në Kosovë gjatë viteve '98-'99 janë krime të rënda, krime të cilat kanë zhdukur familje të tëra. Edhe këtu në familjen Berisha nuk është vetëm krim, po është bërë gjenocid ndaj familjes. Me konventat ndërkombëtare gjenocid quhet, krim i shumëfishtë ndaj një grupi etnik që ka ekzistuar edhe është kryer krimi i shumëfishtë. E them i shumëfishtë sepse janë ekzekutuar në lokal, janë ngarkuar në kamion, janë groposur në poligonin e qitjes së ushtrisë jugosllave në Lubizhdë, janë nxjerrë me eskavator, janë dëmtuar trupat, janë ngarkuar në kamionin frigorifer, janë dërguar në Danub, prej Danubit janë nxjerrë edhe janë dërguar në Batajnicë. Domethënë, krimi ndaj atyre trupave është pesëfish. Edhe për atë është krim gjenocidi", thotë Berisha.

Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha

Në atë hapësirë të vogël, rrëfimi i tij nuk tingëllon si histori e largët. Gjurmët janë ende aty, si rrobat e batanijet, që sikur dëshmojnë në heshtje.

Dhe muzeu i kujtesës nuk u krijua rastësisht. Familjarët vendosën që vendi i masakrës të mos rindërtohej e të harrohej, por të mbetej dëshmi për brezat që do të vijnë.

“Kemi menduar me i tregu këto krime që na kanë ndodhur në familje, dhimbja që na ka ndodhur, edhe për me lënë një trashëgimi për brezat që do të vijnë. Kemi vendosur ta bëjmë një muze edhe pikërisht në lokalin ku është kryer masakra ndaj familjes Berisha, ku ka qenë një piceri e familjes Shala. Me mirëkuptim me pronarin e atij lokali, ai na ka ofruar atë lokal që ta shndërrojmë në muze”, thekson Hysni Berisha.

Ai nuk preferon që të flasë për vështirësitë, por përqendrohet te suksesi i krijimit të hapësirës memoriale.

“Për mua ka qenë një sukses shumë i madh që ne kemi arritur me e bindë pronarin e lokalit që me e lënë atë objekt muze për ta trashëguar, me i pa të gjitha krimet e luftës edhe gjeneratat që do të vijnë. Sot krenohem me këtë punë, me këtë lokal që kemi lënë për muze”.

“Nuk ka dinjitet pa një varr”

Por, krenaria nuk e zbeh dhimbjen. Pas më shumë se dy dekadash, familja Berisha ende jeton me mungesën e mbi 20 personave të zhdukur.

“Edhe sot i kemi edhe 24 të zhdukur të familjes Berisha. Nuk ka dinjitet familja derisa nuk e ka një asht me ditë ku me qit një lule nesër, me ditë ku e ka varrin. Ne i kemi përgatitur varrezat, janë të gjitha ato. Mirëpo edhe 24 janë që nuk janë trupat e tyre”, deklaron ai.

Megjithatë, shpresa mbetet pjesë e përditshmërisë së familjarëve.

“Shpresa nuk vdes asnjëherë. Edhe kur e kam formuar shoqatën për hulumtimin e krimeve të luftës, e kam pagëzuar “Shpresimi” duke u mbështetur në atë që gjithmonë kemi shpresuar që do të vijmë deri te rezultatet. Edhe akoma ne shpresojmë, presim që do të vijnë të paktën me pasur një dinjitet të të gjithë atyre që janë vrarë, të ketë një varr, të ketë ku me çu një lule, të ketë familja ku me u çmall me ta”.

Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha

Vizitorët që hyjnë në muze shpesh largohen me emocione të shumta. Kjo vërtetohet edhe nga libri i përshtypjeve, i nënshkruar nga shumë personalitete ndërkombëtare dhe vendore.

Sipas Berishës shumica e vizitorëve të këtij muzeu nuk mund t'i ndalin lotët e tyre.

"Muzeu ka karakter shumë dimensional. Më shumë ka vizitorë që vijnë nga bota e jashtme, anëtarë të misioneve të ndryshme këtu në Kosovë, pastaj vjen diaspora jonë, vijnë mysafirë edhe në përvjetorë. Ne vazhdimisht e ndiejmë një lehtësim shpirtëror të paktën për atë kohë kur vijnë me na vizitua që e ndajnë dhimbjen me ne. Ato pesë minuta e ndajnë dhimbjen edhe ne jemi më të qetë, më të lirë se dikush po na dëgjon", shprehet Hysni Berisha.

Muzetë si dëshmi kundër mohimit

Për njohësit e drejtësisë tranzicionale, vende të tilla kanë rëndësi të jashtëzakonshme në ruajtjen e kujtesës kolektive dhe në ballafaqimin me të kaluarën.

Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë thotë se muzetë e kujtesës luajnë një rol shumë të rëndësishëm në procesin e drejtësisë tranzicionale, pasi ato shërbejnë si hapësira ku dokumentohen, ruhen dhe komunikohen përvojat e viktimave dhe pasojat e dhunës së ndodhur gjatë luftës, konfliktit apo regjimit diktatorial.

"Drejtësia tranzicionale nuk ka të bëjë vetëm me proceset gjyqësore, por edhe me të drejtën për të vërtetën, kujtesën dhe njohjen publike të vuajtjeve. Në këtë kuptim, muzetë e kujtesës ndihmojnë shoqërinë të ballafaqohet me të kaluarën, të kundërshtojë mohimin e krimeve dhe të krijojë një kulturë të respektimit të të drejtave të njeriut. Ato janë gjithashtu mjete edukimi për gjeneratat e reja, në mënyrë që krimet e së kaluarës të mos harrohen dhe të mos përsëriten. Në të njëjtën kohë, memorializimi krijon hapësira për diskutim dhe reflektim, e që në periudhe afatgjate mund të sjell deri tek ndërtimi i paqes së qëndrueshme dhe pajtimi".

Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha

Sipas tij, dokumentimi dhe ekspozimi publik i krimeve të luftës është thelbësor për një shoqëri post-konflikt.

“Pa dokumentim të besueshëm dhe pa pranimin publik të së kaluarës, ekziston rreziku i relativizimit apo mohimit të krimeve. Dokumentet, fotografitë, dëshmitë dhe artefaktet e ruajtura në muze apo memoriale krijojnë një arkiv kolektiv të kujtesës, i cili i jep zë viktimave dhe kontribuon në ndërtimin e së vërtetës historike. Për më tepër, ekspozimi publik i këtyre krimeve ndikon në ndërgjegjësimin shoqëror dhe në krijimin e empatisë ndaj viktimave”, thotë Blakaj.

Hapësira si Muzeu i Martirëve të Familjes Berisha, sipas tij, kontribuon drejtpërdrejt në ruajtjen e kujtesës kolektive.

“Në rend të parë, pak hapësira ku kanë ndodhur krimet janë ruajtur në atë gjendje siç kanë qenë në kohën e kryerjes së masakrës. Njëra ndër to është hapësira e ish restorantit – picerisë “Kalabria”, ku janë ekzekutuar anëtarët e familjes Berisha. Për shkak se hapësira ka mbetur autentike ky muze e bën kujtesën më të prekshme dhe më personale. Gjithashtu, kjo hapësirë shërben si vend reflektimi dhe respekti për viktimat, por edhe si forma rezistence kundër harresës”.



Në të njëjtën kohë përkujton se rrëfimet e viktimave dhe familjarëve duhet të trajtohen me shumë ndjeshmëri, dinjitet dhe përgjegjësi në proceset memorializuese dhe se viktimat dhe familjarët nuk duhet të shihen vetëm si burime informacioni, por si pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e kujtesës publike.

“Është shumë e rëndësishme që rrëfimet e tyre të prezantohen në mënyrë autentike dhe pa instrumentalizim politik. Në rastin e familjes Berisha dhe rasteve tjera ku ende ka persona të zhdukur, procesi memorializues mbetet i papërfunduar. Mungesa e informacionit për fatin e të zhdukurve e mban të hapur plagën e familjeve dhe e bën kujtesën jo vetëm një akt përkujtimi, por edhe një kërkesë të vazhdueshme për të vërtetën dhe drejtësi”.

Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha

Drejtësia tranzicionale mes dokumenteve dhe realitetit

Në Strategjinë për Drejtësi Tranzicionale të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2024–2034, duke u bazuar në të dhënat organizatës Fondi për të Drejtën Humanitare thuhet se gjatë luftës në Kosovë janë vrarë rreth 13 mijë persona, ndërsa 1,597 persona vazhdojnë të konsiderohen të zhdukur me forcë, përfshirë 109 fëmijë.
Dokumenti përmend masakrat, dëbimet, torturat dhe shkatërrimin sistematik të jetës civile gjatë luftës, sikurse edhe përpjekjet ndërkombëtare dhe vendore për ballafaqimin me të kaluarën dhe drejtësinë tranzicionale.
"Iniciativat e mëparshme që synonin kërkimin e së vërtetës nuk i kanë përmbushur mandatet e
tyre", thuhet aty, teksa pohohet se "transformimi shoqëror nga një kontekst i dhunës sistematike në një bashkëjetesë paqësore është i vështirë për t'u arritur nëse viktimave u mungon kujdesi adekuat dhe nëse nuk zbatohen parimet e drejtësisë tranzicionale".
"Në Kosovë, janë ndërmarrë edhe iniciativa të ndryshme për ta adresuar të kaluarën nga organizatat e shoqërisë civile vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Pavarësisht rëndësisë së këtyre nismave, ato nuk mund ta zëvendësojnë nevojën për adresimin dhe promovimin e drejtësisë tranzicionale nga institucionet publike të Kosovës", shkruan në Strategji.

Sipas Blakajt, qasja e Kosovës ndaj drejtësisë tranzicionale ka pasur përparime, por ende mbetet e fragmentuar dhe e paplotë. Ai shton se janë bërë hapa në dokumentimin e krimeve, së pari duke krijuar Institutin për Krimet e Kryera gjatë Luftës (IKKL), hartimin e Strategjisë nacionale për Drejtësi Tranzicionale dhe nisma tjera.

Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha

“Megjithatë, nuk kemi parë ende ndonjë nismë serioze nga ana e institucioneve të shtetit për fuqizimin e memorializimt dhe krijimin dhe mirëmbajtjen e kujtesës kolektive. Mbi të gjitha, asnjëherë nuk ka pasur një qasje të duhur për përfshirjen dhe vendosjen e viktimave në qendër të proceseve të Drejtësisë Tranzicionale. Si pasojë e kësaj situate shumë viktima dhe familjarë vazhdojnë të ndihen të paintegruar në këto procese, sidomos për shkak të mungesës së drejtësisë së plotë dhe fatit ende të pazbardhur të personave të zhdukur. Megjithatë, shoqatat e familjeve të viktimave, individë nga këto familje dhe organizatat e shoqërisë civile janë ata që për 27 vite kanë bartur barrën e proceseve të drejtësisë tranzicionale dhe ruajtjes së kujtesës mbi të kaluarën e dhunshme”, thotë aktivisti i shoqërisë civile.

Pa drejtësi nuk ka paqe të qëndrueshme

Ai vlerëson se për të forcuar kulturën e kujtesës në Kosovë, nevojitet më shumë përkushtim institucional, mbështetje për muze dhe memoriale, integrim të edukimit mbi të kaluarën në sistemin arsimor dhe mbështetje për dokumentimin profesional të dëshmive dhe arkivave. “Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të krijohen hapësira për dialog ndërmjet komuniteteve dhe përfshirje më e madhe e të rinjve në diskutimet mbi të kaluarën. Kultura e kujtesës duhet të shihet jo vetëm si përkujtim i viktimave, por edhe si investim për paqe dhe demokraci”, nënvizon Blakaj.

Ndërkaq Hysni Berisha flet me zhgënjim për mungesën e mbështetjes institucionale, megjithëse irritimin më të madh e ka me mos vënien e drejtësisë në vend për krimet e luftës, respektivisht mohimin e vazhdueshëm të tyre nga autoritetet në Serbi.

“Pala e cila i ka kryer krimet asnjëherë deri më sot nuk ka kërkuar falje, po vetëm shkon me akuza edhe i akuzon institucionet tona. Na akuzon neve sikur ne jemi kryesit, e ata janë viktimat”, thotë i zhgënjyer ai.

Gjurmët e masakrës dhe heshtja që flet ende në Muzeun e Familjes Berisha



Sipas raporteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave për masakrën në Suharekë dhe në lokalitete tjera, në Hagë janë dënuar gjashtë serbë, respektivisht Vlastimir Gjorgjeviq, Nikola Shainoviq, Dragoljub Ojdaniq, Nebojsha Pavkoviq, Vladimir Lazareviq dhe Sreten Lukiq, me nga 18 deri në 22 vite burgim. Ndërsa Departamenti për Krimet e Luftës në Gjykatën e Qarkut të Beogradit, ka gjykuar tetë persona dhe ka dënuar katër të akuzuarit e përfshirë në këtë masakër.

Mungesa e drejtësisë së plotë, sipas aktivistit Blakaj, ndikon drejtpërdrejt në procesin e pajtimit dhe kujtesës.

“Kur krimet mbeten të pandëshkuara, kur viktimat nuk marrin njohjen dhe drejtësinë e merituar, dhe kur ende ka persona të zhdukur, atëherë plagët e luftës mbeten të hapura. Pa drejtësi dhe pa të vërtetë është shumë e vështirë të ndërtohet besimi ndërmjet komuniteteve dhe një paqe e qëndrueshme. Në këtë kuptim, kujtesa nuk mund të ndahet nga drejtësia , ato janë procese të ndërlidhura që duhet të ecin paralelisht për të krijuar një shoqëri më të drejtë dhe më të ndërgjegjshme për të kaluarën e saj”, shprehet Blakaj.

Pavarësisht mungesës së drejtësisë së plotë dhe viteve të gjata të pritjes, muzeu i familjes Berisha vazhdon të qëndrojë si një vend kujtese kundër harresës.

Vegëza e plotë e artikullit në gjuhën shqipe:
https://tvprizreni.net/gjurmet-e-masakres-dhe-heshtja-qe-flet-ende-ne-muzeun-e-familjes-berisha

Nga Reçaku te bombardimet e NATO-s, rrëfimi i Vjosa Sadriu-Hamiti për gazetarinë e luftës

Jehona Hulaj

Në vitet më të rënda për Kosovën, kur informacioni ishte çështje jete a vdekjeje, gazetaria nuk ishte vetëm profesion - ishte përgjegjësi, mision dhe rrezik i përditshëm. Në një intervistë për Telegrafin, gazetarja e luftës Vjosa Sadriu Hamiti kujtoi periudhën e viteve ’90-ta, raportimet nga masakrat në Kosovë dhe barrën emocionale që mbartnin gazetarët që raportojnë nga konfliktet.

Ajo tregoi se rrugëtimi i saj në gazetari nisi krejt rastësisht në Qendrën për Informim të Kosovës (QIK), fillimisht si përkthyese në gjuhën gjermane, por shumë shpejt u përfshi drejtpërdrejt në raportimin e ngjarjeve që po tronditnin vendin.

“Çdo informatë që ne e merrnim në Qendrën për Informim të Kosovës e verifikonim minimumi njëzet-tridhjetë herë, për shkak se donim të ishim partnerë seriozë dhe të besueshëm për bashkëpunimin ndërkombëtar”, tha ajo.

Një nga momentet më të rënda të karrierës së saj mbetet raportimi nga masakra e Reçakut, ngjarje që tronditi opinionin ndërkombëtar dhe ndryshoi rrjedhën e luftës në Kosovë.

Ajo kujton se më 15 janar 1999 ishte nisur për të raportuar nga ceremonia e ngushëllimeve për vrasjen e Enver Malokut, por situata ndryshoi papritur kur erdhën informacionet e para për atë që kishte ndodhur në Reçak.

“Qysh në hyrje të fshatit, kufoma e parë që e kemi parë ka qenë një burrë që e kishte kokën e prishur nga rrahjet. Ajo ishte fotografia e parë që e kam bërë”, rrëfeu ajo.

Sadriu-Hamiti tregoi se në atë kohë teknologjia ishte minimale dhe gazetarët punonin në kushte jashtëzakonisht të vështira.

Nga Reçaku te bombardimet e NATO-s, rrëfimi i Vjosa Sadriu-Hamiti për gazetarinë e luftës

“Atëherë nuk ka pasur as zë në kamera. Nëse doje ta merrje një pamje, është dashur ta provoje paraprakisht”, tha ajo, duke kujtuar edhe momentin kur fotografitë nga Reçaku u publikuan fillimisht përmes Qendrës për Informim të Kosovës dhe u morën nga mediat ndërkombëtare.



Megjithatë, pjesa më e rëndë nuk ishte vetëm raportimi, por përballja emocionale me pamjet e luftës.

“Unë nuk kam qenë në gjendje të shkruaj. Vetëm tregoja çfarë kam parë dhe të tjerët e bënin lajmin”, tha ajo.

Sot, kur e sheh nga distanca kohore, ajo pranon se trauma ka lënë gjurmë, edhe pse në atë kohë nuk kishin “luksin” të mendonin për pasojat psikologjike.

“Ne s’kemi pasur kohë të merreshim me veten. Të nesërmen vinte menjëherë ngjarja tjetër dhe duhej të ishim të gatshëm”, tha Sadriu-Hamiti.

Ajo kujtoi edhe periudhën e bombardimeve të NATO-s, kur në shtëpinë e familjes së saj në Prishtinë strehohej gazetari i huaj Elias Bierdel i cili po raportonte fshehurazi nga Kosova për radion publike gjermane.

“Ne e morëm atë rrezik si familje, sepse po të zbulohej nga paramilitarët se ai ndodhej tek ne, mund të pësonte e gjithë lagjja”, tregoi ajo.

Në mungesë të telefonave mobil dhe me ndërprerje të vazhdueshme të energjisë elektrike, verifikimi i informacionit ishte jashtëzakonisht i vështirë.

“Ka ndodhur që të prisnim me orë të tëra vetëm për të marrë një sinjal telefoni dhe për ta thirrur dikë”, kujtoi Vjosa Sadriu-Hamiti.

Pavarësisht rreziqeve, Sadriu-Hamiti thotë se gazetarët e asaj kohe e shihnin raportimin si detyrë ndaj vendit, duke shtuar se ka qenë shumë e rëndësishme që lajmi të verifikohej shumë herë para se të publikohej, sepse siç thekson ajo “ne ishim zëri i Kosovës për botën”.

Nga Reçaku te bombardimet e NATO-s, rrëfimi i Vjosa Sadriu-Hamiti për gazetarinë e luftës

Ajo kishte edhe një mesazh për gazetarët e rinj, sidomos për ata që raportojnë nga situata të ndjeshme apo konflikte.

“Të mundohen të jenë sa më objektivë dhe të mos përdorin gjuhë urrejtjeje. Është shumë e rëndësishme të raportosh pa nxitur përçarje”, tha ajo.

Në fund, gazetarja e luftës theksoi se pavarësisht sfidave, gazetaria mbetet një nga shtyllat kryesore të demokracisë.

Vegëza e plotë e artikullit dhe podcast në gjuhën shqipe: https://telegrafi.com/nga-recaku-te-bombardimet-e-nato-s-rrefimi-i-vjosa-sadriu-hamiti-per-gazetarine-e-luftes/

“Me plis kam le, me plis dua të vdes”

Lendrit Qeli

Rrëfimi i të mbijetuarit Bashkim Ramadani për 14 ashkalinjtë dhe egjiptianët e zhdukur në Masakrën e Krushës së Madhe.

Më 26 mars 1999, vetëm dy ditë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, fshati Krushë e Madhe, rreth 11 kilometra larg Rahovecit, u shndërrua në skenë të një prej masakrave më të rënda të luftës në Kosovë.

Gjatë tri ditëve të dhunës sistematike të ushtruar nga forcat serbe, u vranë dhe u masakruan 241 civilë shqiptarë, ndërsa 64 persona vazhdojnë ende të figurojnë të zhdukur.

Në mesin e viktimave ishin edhe 14 pjesëtarë të komuniteteve ashkali dhe egjiptian, të cilët, sipas dëshmive të të mbijetuarve, refuzuan të largoheshin nga fshati dhe qëndruan pranë fqinjëve të tyre shqiptarë deri në momentet e fundit të jetës. Edhe pas më shumë se dy dekadash, familjet e tyre vazhdojnë të jetojnë mes dhimbjes, mungesës dhe pritjes për drejtësi, pasi trupat e tyre ende nuk janë gjetur.

Shumë nga dëshmitarët e asaj kohe nuk jetojnë më. Bashkë me ta janë shuar edhe rrëfime të rëndësishme për krimet dhe për momentet e fundit të viktimave. Megjithatë, kujtesa e familjeve dhe e të mbijetuarve mbetet dëshmi e gjallë e asaj tragjedie.

Njëri prej atyre që i mbijetoi masakrës është Bashkim Ramadani. Ai arriti të shpëtojë, por humbi babanë dhe dy vëllezërit, të cilët u ekzekutuan gjatë ngjarjeve tragjike të marsit 1999. Edhe sot, pas 26 vitesh, familja ende nuk e di se ku prehen eshtrat e tyre.

“Jetonim me punë e me djersë. Nuk kishim shumë, por kishim zemër e respekt për njëri-tjetrin. Me fqinjët shqiptarë ishim si familje. Në gëzime e në mort, gjithmonë bashkë,” kujton Ramadani. Por gjithçka ndryshoi brenda pak orësh.

“Me plis kam le, me plis dua të vdes”

Me fillimin e bombardimeve, frika përfshiu gjithë fshatin. Banorët u detyruan të largoheshin drejt maleve për t’i shpëtuar sulmeve të forcave serbe. Nga larg dëgjoheshin zhurmat e tankeve dhe të shtënat që afroheshin gjithnjë e më shumë.

“Pasi qëndruam deri në mbrëmje në mal, rrezikova dhe u afrova afër fshatit për me pa çka ka mbet prej shtëpisë. Pashë vetëm zjarr e tym. Krejt Krusha ishte në flakë. Mu duk sikur po digjej krejt jeta jonë bashkë me shtëpitë,” rrëfen ai.



Familjet kaluan natën të fshehura në mal, mes pasigurisë dhe frikës së vazhdueshme. Të nesërmen, granatimet dhe të shtënat u afruan edhe më shumë. Në ato momente paniku, Bashkimi i kërkoi babait të largohej bashkë me familjen drejt
një zone më të sigurt. Por ai refuzoi.

Pak para ndarjes së fundit, Bashkimi i kërkoi babait ta hiqte plisin e bardhë, nga frika se mund të identifikohej më lehtë nga forcat serbe. Përgjigjja e tij mbeti përgjithmonë në kujtesën e familjes:

“Me plis kam le… me plis dua të vdes.”

Ishin fjalët e fundit që dëgjoi prej tij.

Për shkak të përkeqësimit të situatës dhe frikës se mund të zbuloheshin nga forcat serbe, familjarët dhe banorët e fshatit vendosën të ndaheshin në grupe të vogla, me shpresën se të paktën një pjesë do të arrinte të mbijetonte. Ideja ishte që të mos qëndronin të gjithë bashkë në një vend, nga frika se mund të ekzekutoheshin të gjithë në rast se binin në duart e paramilitarëve serbë.

Pas ndarjes në grupe, babai i Bashkimit dhe dy vëllezërit e tij mbetën veçmas së bashku me disa burra të tjerë. Sipas dëshmive të grave të mbijetuara që ndodheshin me ta në ato momente, edhe ata ranë në pritën e forcave serbe. Paramilitarët urdhëruan që burrat të ndaheshin menjëherë nga gratë dhe fëmijët, ndërsa grave dhe fëmijëve iu tha të largoheshin pa guxuar të kthenin kokën prapa.

“Ecni dhe mos guxoni me kthy kryt mbrapa, duart mbani lartë,” bërtisnin paramilitarët, ndërsa burrat mbetën të ndaluar. Vetëm pak çaste më vonë u dëgjuan breshëri armësh.

“Me plis kam le, me plis dua të vdes”

Që nga ajo ditë, familja Ramadani nuk i pa më kurrë babanë dhe dy vëllezërit e Bashkimit.

Por, tmerri nuk përfundoi aty. Vetë Bashkim Ramadani, së bashku me dhjetëra civilë të tjerë, u kap më vonë dhe u dërgua në xhaminë e fshatit, e cila gjatë atyre ditëve ishte shndërruar në vend torturash, rrahjesh dhe ekzekutimesh. Për afro 24 orë, të mbyllur brenda xhamisë, ata jetuan mes frikës, britmave dhe pritjes së vdekjes.

“Xhamia nuk dukej më si xhami. Ishte si ferr. Gjithandej gjak, britma e frikë. Çdo pak minuta merrnin dikë jashtë… e pastaj dëgjoheshin krismat,” kujton ai.

Ai kujton fytyrat e njerëzve të tmerruar, veçanërisht djemve të rinj, vetëm 14–15 vjeç, ende fëmijë, të cilët qanin nga frika ndërsa prisnin fatin e tyre.

“Djemtë më pyetnin: ‘Babë, a kanë me na vra?’ Mundohemi me i qetësu… por në fund edhe vet e humba shpresën.”

Sipas tij, pas orësh të tëra torture psikologjike dhe dhune, askush brenda xhamisë nuk besonte më se do të dilte i gjallë.

“Nuk kishim më shpresë për jetë. Veç pritshim kur po na vjen radha,” thotë ai.

Të nesërmen, paramilitarët dhe policët serbë i nxorën civilët jashtë xhamisë dhe iu urdhëruan të vraponin.

“Na thanë: ‘Ikni, vraponi!’ E derisa po ikshim, ata shtinin me armë kah mujshin. Njerëzit u shpërndanë në panik… kush kah mundej,” rrëfen Ramadani.

Edhe sot, ai nuk arrin ta kuptojë se si arritën të shpëtonin.

“S’di as vet qysh kemi shpëtu. Veç kemi vrapu në drejtim të magjistrales prej Krushës së Madhe për në Prizren, nëpër frikë, britma e plumba.”

“Me plis kam le, me plis dua të vdes”

Ashkalinjtë dhe egjiptianët e zhdukur në Krushë të Madhe

- **Skënder M. Beqiri (1941) – 58 vjeç;**
- **Mahir S. Beqiri (1964) – 35 vjeç;**
- **Kujtim S. Beqiri (1971) – 28 vjeç;**
- **Arben S. Beqiri (1976) – 23 vjeç;**
- **Petrit S. Beqiri (1978) – 21 vjeç;**
- **Xhemali O. Ramadani (1930) – 69 vjeç;**
- **Milaxhim Xh. Ramadani (1968) – 31 vjeç;**
- **Blerim Xh. Ramadani (1976) – 23 vjeç;**
- **Mahmut A. Mahmuti (1939) – 60 vjeç;**
- **Fatmir M. Mahmuti (1965) – 34 vjeç;**
- **Xhavit M. Mahmuti (1969) – 30 vjeç;**
- **Nahit M. Mahmuti (1971) – 28 vjeç;**
- **Asllan R. Sahiti (1966) – 33 vjeç;**
- **Ymer B. Iseni (1975) – 24 vjeç.**



Ata nuk ishin vetëm emra në një listë. Ishin baballarë, bijë, vëllezër dhe fqinjë, të cilët refuzuan të largoheshin nga fshati i tyre dhe ndanë fatin me bashkëfshatarët shqiptarë deri në momentet e fundit të jetës.

Për familjet e Krushës së Madhe, lufta nuk ka përfunduar ende. Ajo vazhdon në heshtjen e varreve që mungojnë, në pritjen për drejtësi dhe në kujtimet që nuk i shuan as koha. Sepse në Krushë të Madhe, emrat e viktimave nuk janë vetëm pjesë e historisë, ata mbeten plagë të hapura të një komuniteti që ende pret paqe për shpirtin e të zhdukurve.

Vegëza e plotë e artikullit në gjuhën shqipe: https://rtv-prosperiteti.com/me-plis-kam-le-me-plis-dua-te-vdes-rrefimi-i-te-mbijetuarit-bashkim-ramadani-per-14-ashkalinjte-dhe-egjiptianet-e-zhdukur-ne-masakren-e-krushes-se-madhe/

Ekipi i projektit

Ekipi i Projektit

Vjollca Islami Hajrullahu
Menaxhere e projekteve, Pro Peace - Programi në Kosovë

Nehari Sharri
Drejtor i Zyrë s, Pro Peace - Programi në Kosovë

Xhemajl Rexha
Redaktor i artikujve

Getoarbë Mulliqi
Drejtore ekzekutive, AGK

Artiola Babuni
Koordinatore e projekteve, AGK